



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 korrik 2015, në mbledhjen e XIX-të (nëntëmbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç znj.Afërditë Lutfiu e cila mungoi.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen me një fjalë hyrëse rreth kësaj mbledhje dhe shtoi, konsideroj se rendin e propozuar të ditës dhe materialin përkatës e keni marr me kohë duke përfshirë edhe piken shtesë të rekomanduar nga Komiteti për Politikë dhe Financa, andaj nëse nuk ka të interesuar për të marr fjalën, unë e hedh në votim, rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe në kuadër të pikës së tetë të rendit të ditës përfshihet edhe pika shtesë:

- **Propozim vendimet për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore** (për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeqel)

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 26 qershor 2015

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

3. Raporti i Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse, ku në formë të përgjithësuar shpalosi Raportin e Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014. Ndër të tjera theksoi, Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm i dhënë për Komunën e Podujevës është, Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes, me të cilin ne jemi të kënaqur duke synuar që në raportet e ardhshme t'i përmirësojmë apo t'i eliminojmë në tërësi të gjeturat përkatëse, po e citoj atë që raport thuhet, *sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale*, pra mund të themi se një opinion i tillë nga Auditori i Përgjithshëm jepet atëherë kur ky auditorë është i kënaqur në të gjitha aspektet, ngase siç thuhet në raport, pasqyrat financiare të Komunës janë përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Konkluzioni i përgjithshëm i Auditorit është, se sistemi i kontrollit të brendshëm i vendosur nga Komuna, në shumicën e fushave funksionon në mënyrë efektive, mirëpo në disa fusha ende kanë mbetur dobësi, fusha të cilat janë të cekura në Raport, për të cilat janë dhënë edhe rekomandime që në të ardhmen të mos përsëriten. Ne kemi paraqitur një planë të veprimit në mënyrë që në të ardhmen t'i ndërmarrim veprimet e nevojshme për të mos u përsëritur këto çështje, andaj unë personalisht jam i kënaqur me këtë opinion të Auditorit sepse sipas tij tatimpaguesit mund të jenë të kënaqur ngase taksat e tyre janë duke u përdorur në mënyrë korrekte.

z.Fidan Rekalu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Raportin e Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014 e vlerësojmë si raport real dhe i cili me opinionin e dhënë jep një pasqyrë dhe paraqet gjendjen reale në Komunën e Podujevës, opinion në të cilin është konstatuar se pasqyrat vjetore financiare janë prezantuar në një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Gjithashtu ne si Grup i këshilltarëve, kërkojmë nga Ekzekutivi i Komunës që të merren për bazë rekomandimet e dala nga opinionin e Auditorit të Përgjithshëm i dhënë në këtë raport.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur një ditë më parë ne kemi diskutuar rreth këtij raporti, gjithashtu drejtori parafolës e paraqiti një fjalim të shkurtër rreth gjendjes së këtij raport, po ashtu parafolësi përfaqësues nga LDK-ja e lavdëroi këtë raport, mirëpo unë në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, ju them se e kam analizuar këtë raport real duke mos u munduar të përqesh as të lavdëroj për inate partiake ose nga aspekti i opozitës. Raporti i Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014, i ka të njëjtat vërejtje nga raporti për vitin 2013, vërejtje të cilat kanë mbetur pa u përmbushur dhe që janë marrë si obligim nga Ekzekutivi se do të përmbushen në vitin 2015 e të cilat mendoj se prapë në raportin e ardhshëm do të jenë të njëjta. Në këtë raport përshtypje të madhe më ka bërë pasuria komunale, mirëpo në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar që drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ) të jetë prezent në mbledhjen e Kuvendit në mënyrë që të na jap sqarime rreth pronave të Komunës përkatësisht të hyrave vetanake nga qiraja e pronave të dhëna në shfrytëzim, mirëpo drejtori prapë nuk është prezent sot, dhe për këtë e kam thënë dhe po e përsërisë se drejtori i DPKGJ e ka gjetur rrugën më të mirë sipas tij që të

mos jetë prezent në sallë për të dhënë sqarime të nevojshme, sigurisht se të gjithë këshilltarët e Kuvendit jeni në dijeni dhe e keni pranuar në e-mail një dokument nga drejtori i DPKGJ z.Abaz Llugaliu, dokument në të cilin janë futur si pasuri zyrtare komunale vetëm kullosat dhe pyjet e jo një numër i barakave me ndërtim të vogël të cilat e kanë vlerën më të vogël në Kuvendin e Komunës. Një ndër vërejtjet e Auditorit janë të hyrat vetanake dhe gjendja e pronës komunale, dhe po ashtu përshtypje më ka bërë që drejtori i lartcekur nuk e ka futur si pronë komunale objektin e ish Postës në fshatin Lluzhan, objekt i cili po të jepej në shfrytëzim me një çmimi shumë të ulët sigurisht se të paktën 200 € do të inkasoheshin nga ana e Komunës, mirëpo ai objekt është uzurpuar që 15 vite nga kryetari i degës së LDK-së së atij fshati, dhe i cili e ka një vendim gjyqësorë për lirim të atij objekti por që nuk është liruar, ne kemi bërë disa herë kërkesë por nuk është ndërmarr asgjë, shembull tjetër që nuk është futur në këtë listë të pronave komunale e kemi lokalin “Milleniumi 2000” në fshatin Orllan i cili funksionon që 15 vite dhe që personi që e ka shfrytëzuar atë, tash e ka dhënë me qira dikujt tjetër, gjithashtu problem tjetër, dhe që e kemi trajtuar edhe para se të jepet ai në shfrytëzim, paraqet edhe lokali në qendër të qytetit ish Banka për Biznes, lokal i cili është ndarë në dy pjesë ku njëra pjesë është lëshuar me qira nga personi që i është dhënë në shfrytëzim, pastaj janë kryer punime pa mbikëqyrje të Inspeksionit dhe nuk janë marrë kurrfarë veprimesh nga askush, por është nënshkruar një Kontratë mes Kryetarit të Komunës dhe personit përkatës ku në atë kontratë thuhet që pagesa e qerasë të bëhet për 6 muaj para se të nënshkruhet kontrata, mirëpo pagesa është bërë 3 muaj pasi është nënshkruar kontrata dhe atë vetëm për tre muaj, andaj nuk mund të kuptoj se çfarë lëvdatash mund të ketë ky raport. Çështje tjetër, është keqpërdorimi i parasë publike, sa për ilustrim e marr kompaninë IOM e cila ka funksionuar në Kosovë që nga paslufta, për rregullimin e rrethojave të shkollës “Isa Boletini” për të cilën ka qenë një kontratë, por ka pasur participim edhe nga Komuna me një shumë mbi 16 mijë euro, ku paratë i janë dhënë kompanisë 6 muaj para se të fillon punimet, andaj kjo është e ndaluar me të gjitha dispozitat ligjore. Gjithashtu përshtypje në raport më ka bërë edhe, ekzekutimi i pagesave me vendime gjyqësore, ku Komuna ka kontraktuar punë, janë kryer punët mirëpo nuk janë bërë pagesat dhe është dashur që përmes vendimeve gjyqësore të kryhen ato pagesa, për të cilën jemi në dijeni se për të gjitha ato vendime paguhen edhe taksat dhe kamatat prej 2.5% për shumën e caktuar, andaj kemi rreth 200 mijë euro pagesa të tilla dhe mund të kalkuloni kamatën prej 2.5% për vonesa, e të cilat e prishin ekuilibrin financiar të Komunës. Sa i përket tatimit në pronë të paluajtshme, Ekzekutivi i Komunës gjithëherë është ankuar se nuk ka inkasime të mjaftueshme të mjeteve, kurse nga viti 2013 borxhi i Komunës është rritur 17%, ne kemi kërkuar që në Kuvend të sjellët një listë e borxheve të vjetruara, mirëpo mbledhja e borxheve është përgjegjësi e drejtorisë përkatëse dhe se dihet se cilat borxhe fshihen në baza vjetore. Lidhur me vërejtjen për kontratat e veçanta, unë nuk mund të kuptoj se si mund të ndodh kjo kur ekziston Ligji përkatës që e rregullon këtë çështje, ku duhet të ketë ofertë e hapur përmes prokurimit me kandidat ekspertë të fushave të caktuara për punë të cilat Komuna nuk ka personel adekuat për punë të caktuara dhe të cilat mund të lidhen në një afat të shkurtër, e jo të ketë 14 kontrata me kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, e kuptoj se drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave është dashur t'i bëjë ato pagesa sepse kontratat ekzistojnë, andaj do të ishte mirë të na jepet një sqarim për ato 14 kontrata se cilët janë ata ekspert dhe çfarë pune kanë kryer si fushë specifike në Komunën tonë ata persona.

Sa i përket shëndetësisë, përshtypje më kanë bërë kontratat mbi vepër të cilat janë lidhur në kohëzgjatje mbi gjashtë muaj, dhe për këtë kam pyetje konkrete për drejtorin e Drejtorisë përkatëse, sa kontrata mbi vepër janë të lidhura në sektorin e shëndetësisë në Komunën tonë, sa prej tyre janë mbi gjashtë muaj dhe sa janë të lidhura në kohëzgjatje mbi një vit, unë jam në dijeni me emër e mbiemër për dy raste përkatësisht në fshatrat Dumnicë dhe Bradash që janë me kontratë mbi vepër në kohëzgjatje më shumë se një vit e që është shkelur Ligji i punës dhe Ligji për shërbim civil. Do të thotë këto që i ceka kanë qenë disa prej vërejtjeve dhe rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, si dhe jemi në dijeni se në vitin 2013 Komuna e Podujevës është renditur një prej 10 Komunave me performancën më të dobët të menaxhimit të parasë publike, mirëpo të njëjtat vërejtje dhe rekomandime Auditori i jap edhe në raportin për vitin 2014, që dua të them se asnjë rekomandim i Auditorit nga viti 2013 nuk është përmbushur me normën 100%.

Zotëri Kryesues i Kuvendit, meqë drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, që dy mbledhje radhazi nuk është prezent në Kuvend, unë në emër të Grupit të PDK-së kërkoj, që në mbledhjen e radhës të sjellët lista e pronave të uzurpuara, listën e pronave të Komunës të dhëna në shfrytëzim pa vendim të Kuvendit të Komunës, dhe lista e pronave me borxhe të vjetruara, paraqita këto kërkesa sepse neve na është dërguar një listë me prona, kullosa dhe pyje, e që ne nuk kemi kërkuar diçka të tillë, dhe të jepet një sqarim pse nuk janë futur pronat tjera në atë dokument që na është dërguar, pra kjo është një kërkesë zyrtare në emër të Grupit.

z.Haki Rudari, theksoi, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me raport të Auditimit të Përgjithshëm, konsideroj se do të ishte mirë të ishte prezent edhe Kryetari i Komunës sepse shumë nga rekomandimet e dala nga ky raport i drejtohen Kryetarit të Komunës së bashku me Ekzekutivin e Komunës. Duke ditur që misioni i Auditimit është të kontribuoj në menaxhim të shëndosh financiarë në administratë publike, të ndërtoj një besim në shpenzimin e fondeve publike dhe të promovoj drejtpërdrejtë llogaridhënien për çdo organizatë buxhetore. Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje së bashku me kryesinë e qendrës ka analizuar në detaje këtë raport të Auditimit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin 2014, dhe konkluzion i përgjithshëm është se; Sistemi i kontrollit të brendshëm i vendosur nga Komuna funksionon në disa fusha, por ende ka dobësi në disa fusha të rëndësishme të qeverisjes, pra ky konkluzion është dhënë në raport. Auditori është fokusuar në tri çështje; pasqyrat vjetore financiare, reagimi ndaj rekomandimeve të vitit paraprak dhe atyre të viteve të kaluara, dhe në çështjet e qeverisjes në veçanti menaxhimi financiarë dhe kontrolli, do të thotë janë këto tri shtylla për të cilat është bërë Auditimi. Në këtë raport janë identifikuar disa çështje për të cilat unë do të thoj se janë shkelje ligjore, si vijon;

1-klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike joadekuate ku Komuna kishte regjistruar si investime kapitale vlerën prej 54,373.00 € të shpenzuara për mallra dhe shpenzime, e që në një kërkesë të Grupit të LVV-së na është thënë se mjetet nuk mund të barten nga një kod në kodin tjetër, por në fakt janë bartur dhe auditori e cilësuar si shkelje.

2-mungesa e regjistrimit të pasurive të Komunës ku ndër të tjera thuhet, edhe pse kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVP të jetë e saktë, por menaxhmenti nuk i kishte ndërmarrë këto veprime, e që do të thotë se është përsëritje nga viti paraprak.

3-procesi i përgatitjes së pasqyrave jo në nivel të duhur.

4-adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak nuk është zbatuar plotësisht, të jem më i saktë, një adresim është zbatuar në tërësi kurse tetë të tjera pjesërisht apo në proces të adresimit dhe një nuk adresuar fare.

5-proceset e llogaridhënies rezultojnë me dobësi në raportim të brendshëm ku raportimi te Kryetari i Komunës bëhet në mënyrë ad-hoc dhe jo në mënyrë sistematike dhe me shkrim nga ana e drejtorëve të drejtorive për punën dhe aktivitetet e tyre, kjo besoj se ndërlidhet edhe me kërkesën e një këshilltari të LVV-së që të kemi raport të plan programit vjetor, shkelje të cilën e ka gjetur edhe Auditori dhe do të dëshiroja të mos përsëritet në vazhdim.

6-pagesat sipas vendimeve gjyqësore janë bërë për shkak të moskryerjes me kohë të obligimeve të cilat kanë rezultuar me padi gjyqësore, pra janë bërë pagesa të shumta si rezultat i kryerjes së borxheve.

7-te të hyrat nga dhënia me qira e pronës komunale janë identifikuar si dobësi, dhe unë nuk do merrem me këtë sepse do të merret më në detaje kolegu nga Grupi jonë.

8-dobësi në prokurim, në mbledhjen e KPF-së kam kërkuar përgjigje rreth disa çështjeve mirëpo nuk më janë dhënë, por shpresoj që sot do të më jepen, në lidhje me tenderin "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc" në vlerë 135,764.00 €, ku procedurat e vlerësimit të tenderëve kanë zgjatur më shumë se 30 ditë pas hapjes së tenderit, kurse me Ligjin e Prokurimit Publik parashihet që vlerësimi i tenderëve të bëhet brenda 30 ditëve, dhe vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të vazhdohet afati i vlerësimit edhe për 10 ditë, plus kjo kontratë për operatorët ekonomik të eliminuar nuk është ofruar si dëshmi se si janë eliminuar ata, edhe pse parashihet që përmes postës ose në e-mail, operatorëve të eliminuar duhet t'i adresohet arsyeja e eliminimit.

9-Komuna e Podujevës ka të punësuar punëtorë me kontratë për shërbime të veçanta, janë identifikuar 14 raste me kohëzgjatje më shumë se 6 muaj, madje thuhet, që nga viti 2010 ka punëtorë të punësuar me kontrata mbi vepër, andaj nuk di si mund të quhet raport i mirë ky.

10-ndalesat dhe kompensimet për paga tregojnë për kontrollet e dobëta gjatë procedimit të pagave dhe rritin rrezikun e pagesave jokorrekte dhe jo në përputhje me ligjet, në mbledhjen e KPF-së u diskutua një rast që në shtëpinë e shëndetit në Podujevë një punëtoreje i është paguar paga e plotë për një vit gjatë pushimit të lehonisë edhe pse me ligj parashihet që paga e plotë mund të jepet vetëm për 6 muaj, edhe shkelje është gjetur nga Auditori dhe është theksuar në Raport.

11-Komuna nuk ka procedura të brendshme të shkruara për menaxhimin e pasurive siç kërkohet me Rregulloren për menaxhimin e pasurisë 02/2013.

12-mungesë të protokollit me rastin e pranimi të faturave në Komunë.

13-mungesa e auditimit në fushën e prokurimit dhe mos adresim i rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, pra në këtë raport të Auditimit janë shumë vërejtje të drejtuara në Auditimin e Brendshëm, dhe pyes, përse nuk ka auditim të brendshëm, përse nuk funksionon Komiteti i Auditimit, andaj për këtë arsye e thash në fillim se do të ishte mirë që Kryetari i Komunës të jetë prezentë këtu në mënyrë që të jepen përgjigje.

Të nderuar të pranishëm duke u nisur nga të gjitha këto shkelje, unë nuk besoj se këtë raport mund ta quajmë të mirë, dhe Grupi i LVV-së e ka thënë dhe do të thotë edhe në të ardhmen se aty ku bëhen shkelje do t'i identifikoj, do t'i thotë dhe pa problem do t'i raportoj kudo që paraqitet nevoja.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, në mbledhjen e kaluar Kryetari i Komunës e ka përmendur raportin e Auditorit të Përgjithshëm të cilin e vlerësoi shumë lartë duke thënë që Auditori e ka vlerësuar në mënyrë të shkëlqyeshme punën e Ekzekutivit, dhe nga kjo kam menduar se nuk do të merrem shumë seriozisht me këtë raport, gjithnjë duke besuar në fjalët e Kryetarit, mirëpo duke shfletuar këtë raport shoh se ka shpërputhje me atë që Kryetari e kishte thënë, sepse Auditori i përgjithshëm i ripërsëritë të gjeturat dhe rekomandimet të cilat i ripërsëritë edhe vitet e mëparshme, meqë drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave duhet që ta lavdëron punën e tyre, unë si opozitë do t'i theksoi të gjeturat tjera që janë bërë; shpalosjet e pasurive dhe klasifikimi në kode ekonomike në PVP nuk është bërë në pajtim me kërkesat ligjore, pastaj menaxhimi i të hyrave nga qiraja e pronës komunale ku nuk kryhen obligimet ndaj Komunës, që do të thotë se Komuna ka kontrata me shfrytëzuesit e objekteve komunale mirëpo nuk i paguhen qiratë, dhe tani mund të lindin dyshime se mos ndokush nga administrata komunale i ndan me ndokënd që ka obligime ndaj Komunës. Pastaj, sigurimi i ekzekutimit për projekte të ndryshme kishte skaduar para se projektet të përfundojnë, edhe këtu lind dyshimi se mos ndokush nga Ekzekutivi ose nga Administrata e Komunës po përfiton nga këto gjëra. Pagesat e punëtorëve me kontratë mbi vepër mbi gjashtë muaj në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit civil, ku vitin e kaluar kanë qenë 14 të punësuar, një vit më parë kanë qenë 24 persona, kurse në këtë vit që jemi nuk jemi në dijeni sa janë, dhe tani shtroj pyetje, a mos po ndodh që Ekzekutivi i Komunës për të ngjallur aktivitetin e partisë përdor këto kontrata për aktivistët e vet sepse jam në dijeni se dy vite më parë ka qenë një numër i konsiderueshëm i kryetarëve të nëndegëve të LDK-së që kanë punuar me kontratë mbi vepër, madje edhe me vite të tëra. Konstatim tjetër është, Komuna ka hyrë në obligime pa garancione se punët do të kryhen, gjithashtu Komuna nuk ka bërë regjistrimin e të gjitha pasurive në regjistrin kontabël, Auditori i Brendshëm nuk ka kryer auditim të brendshëm në fushën e prokurimit që konstatohet me rrezik të lartë, pastaj regjistri i pasurive fikse nuk është as i plotë dhe as nuk është i saktë sepse vlera prej 458,142.00 € as nuk është regjistruar në regjistrin kontabël e as nuk është prezantuar në PVP, mungesa e regjistrimit të pasurive të Komunës paraqet rrezik të identifikuar, dhe tani mund të them atë që e ceken edhe parafolësit, si ka mundësi që Komuna të ketë vetëm një kioskë në regjistrin e pasurive, unë konsideroj se ka edhe pasuri tjera. Çështje tjetër, lidhur me pyetjen që kam parashtruar në mbledhjen e kaluar, unë mora një përgjigje nga Drejtoria e Administratës në të cilën thuhet se Komuna ka shitur 8 automjete në shumë 2,534.00 €, jam në dakord që Komuna e ka ripërtërirë autoparkun dhe nuk ka pasë nevojë më për ato automjete, mirëpo të jem i sigurtë, nuk e kam lexuar ligjin dhe nuk jam në dijeni për këtë por i kam konsultuar ekspertët të cilët më kanë thënë se Komuna nuk ka të drejtë të shes pasurinë e saj pa pasur vendim nga Kuvendi i Komunës, andaj nëse vërtetë është ashtu nuk do të ishte punë e mirë kjo, nëse jo atëherë nuk kam çka të them. Përkundër të gjeturave që i ceka, unë kam dyshim edhe në objektivitetin e Auditorit, jam në dijeni se Auditori pasqyrimin e bënë në bazë të mostrave, megjithatë ka disa gjëra që bëhen në vazhdimësi dhe që janë prezentë në Komunën tonë dhe asnjëherë nuk janë evidentuar si të gjetura.

z.Flakron Gashi, theksoi, dua të filloj fjalimin tim me një thënie popullore, “kush nuk e lavdëron veten, iu kalltë shtëpia”. Është praktikë e çdo qeverisje që për veten e saj të jap vlerësime pozitive për mënyrën e qeverisjes, e ndaj këtij fenomeni nuk është imune as Komuna jonë, ku specifikisht ceket edhe në faqen 13 të këtij raporti. I nderuari drejtor (i drejtohet drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave) unë dua t'i them vetëm ato

të cilat ju ose nuk i keni parë ose nuk keni dashur ose nuk keni ditur t'i lexoni, dhe këtë raport po e plotësoj në të dy anët e medaljes. Tek segmenti i qeverisjes, vetëvlerësimi, raporti specifikisht iu drejtohet, në të ardhmen, Komunës i duhet të jetë më kritike ndaj rezultateve të arritura. Menaxhimi i rrisht, Komuna nuk posedon një listë identifikimi për rreziqet potenciale me të cilat mund të përballlet, Komuna duhet të implementoj një proces formal të vlerësimit të rreziqut. Pastaj, dobësitë tjera evidente në mënyrën e raportimit të brendshëm, thuhet, forma e raportimit që bëhet tek Kryetari bëhet në mënyrë ad-hoc dhe jo në mënyrë sistematike dhe nuk ka raportim me shkrim prej drejtorëve në baza të rregulltave mbi punët dhe aktivitetet e tyre përkatëse. Rreziku, raportimi i brendshëm i pamjaftueshëm nga ana e drejtorëve tek Kryetari i Komunës, redukton aftësinë e menaxhmentit për të drejtuar në mënyrë efektive aktivitetet e Komunës, për të reaguar ndaj sfidave financiare në kohën e duhur dhe për të zbatuar kontrollin efektiv të buxhetit. Gjithashtu Auditori i Përgjithshëm në këtë raport ka evidentuar edhe rreziqet domethënëse në pasqyrat vjetore financiare, të cilat janë; 1-klasifikimi i shpenzimeve në kode ekonomike jo adekuate, dhe 2-mungesa e regjistrimit të pasurive të Komunës.

Nga pronat e dhëna me qira, Komuna ka realizuar vetëm 72% të planifikimit sa ishte paraparë për vitin paraprak, ka raste ku qiramarrësit gjatë vitit 2014 nuk kanë paguar qira fare, shtrohet pyetja konkrete të cilën e përmendi edhe kolegu z.Rafet Llapashtica nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së, pronë e kujt është parcela apo toka në të cilën operon restorant “Milleniumi 2000” në fshatin Orllan tek Liqeni i Batllavës, unë këtë e di dhe besoj të gjithë e dinë, por a nuk keni dashur të flisni apo ka ndonjë marrëveshje prapa kësaj, këtë pronë restorant e ka shfrytëzuar Nuredin Ibishi – Leka, tani deputet i Kuvendit të Kosovës nga radhët e LDK-së. Çështje tjetër ka të bëjë me një sqarim për kolegun këshilltar nga radhët e AAK-së, nuk mund të bëhet pagesë e rregullt ligjore përmes sistemit bankar për një pronë të cilën Komuna nuk e njeh si pronë të vetën dhe që nuk e ka pjesë të regjistrimit, prandaj aty ose u bë pagesa ose nuk është bërë pagesa fare ose atë pagesë apo interes e ka nda dikush tjetër. Është për tu theksuar se vetëm për vitin 2014 thesari në emër të Komunës së Podujevës ka ekzekutuar pagesa sipas vendimeve gjyqësore në vlerë prej 170,781.00 €, ndërsa sipas nenit 39.2 të Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi ishin ekzekutuar 42,767.00 €, pra Komuna ka qenë në obligime apo borxhe në vlerë 0.2 milion euro. Shumat e ekzekutuara në bazë të vendimeve gjyqësore dhe në bazë të kërkesave të operatorëve mund të ndikojnë në çrregullimin e bilancit buxhetor dhe të rrisin rrezikun që objektivat e planifikuara të mos realizohen. Pastaj tek fusha e prokurimit, që është thelbi ose segmenti më kyç dhe domethënës përmes të cilit duhet të kalojnë dhe të filtrohet çdo shpenzim që bëhet nga ana e Komunës, sikur edhe vitet paraprake janë evidentuar shkelje, pra kjo është praktikë e kësaj Komune që çdo vit të ketë shkelje të Ligjit nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, konkretisht neneve 54, dhe 57.1, gjithashtu janë evidentuar edhe shkelje të tjera ligjore siç është rasti me shkeljen e nenit 12 pika 4 të Ligjit nr.03/L-149 për shërbimin civil ku Komuna ka të punësuar punëtorë me kontratë për shërbime të veçanta, ku kohëzgjatja e këtyre kontratave është më e gjatë se gjashtë muaj, madje edhe nga viti 2010. Kulmi i gjithë kësaj, kur bëhet fjalë për prokurimin ka qenë, që lenë hapësirë për të dyshuar se në Komunën e Podujevës ka manipulime me tenderë, është fakti se Njësia e Auditorit të Brendshëm gjatë vitit 2014 nuk ka kryer asnjë auditim në fushën e prokurimit, me arsyetim se nuk ju ka premtuar koha. Nuk mund të anashkalohet një fakt ku gjatë periudhës janar-qershor 2015 nga gjithsejtë 33 projekte kapitale sa janë realizuar

gjithsejtë më shumë se 60% e tyre janë në duart e kompanive të cilat janë të varura direkt nga Kryetari z.Agim Veliu apo anasjelltas, e që ka hapësirë me dyshuar se është e mundur të jetë shkelur neni 7 pikat 1 dhe 2 e Ligjit nr.04/L-042 të prokurimit publik. Prandaj Njësia e Auditorit të Brendshëm nuk është se nuk ka pasur kohë të bëjë auditim të brendshëm në fushën e prokurimit brenda 365 ditëve të një viti, por të nderuar kolegë ne të gjithë e dimë por dikush hesht dhe nuk guxon të flas, sepse për auditimin e prokurimit dhe vendimmarrjen e shpërndarjen e tenderëve e bënë vetë Kryetari i Komunës. Pra ky raport rithekson sikur edhe në vitet paraprake se; sistemi i brendshëm i qeverisjes është jo mirë, konfirmon në më shumë se në tri raste shkelje ligjore, sikur çdo vit paraprak, dhe, paaftësi e menaxhimit të pronave dhe menaxhimit si pasuri publike.

z.Bahri Selimi, theksoi, u thanë shumë gjëra dhe të ngjashme rreth raportit të Auditimit të Përgjithshëm, do të mundohem që mos t'i përsërisë të gjitha ato që u thanë, por vetëm dua të ndalem te çështja që ka të bëjë pronat e paluajtshme për të cilat do të them diçka që deri më tani nuk u përmend, këtë e them duke pasur parasysh se jam edhe anëtar i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, fillimisht dua t'iu them se Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në dy mbledhjet paraprake ka kërkuar një raport nga kryesuesi i komisionit i cili është edhe drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, raport rreth dhënies së pronave komunale në shfrytëzim, por edhe pas tre muajve nuk na është ofruar një raport i tillë, ndërsa tani na del se sipas raportit të Auditimit të Përgjithshëm nxirret në pah ajo çfarë ne kemi kërkuar. Thuhet se është shkelur një kontratë e Kryetarit me qiramarrësin ku nuk është bërë një pagesë e qirasë gjashtë muaj përpara ashtu siç parashihet me kontratë, gjë për të cilën e përgëzoj Auditorin që ka mundur të identifikoj këtë lëshim, mirëpo ka edhe shumë çështje tjera të cilat Auditori nuk i ka identifikuar të cilat ende mbesin anonime, pra është shkelur kontrata e lidhur mes Kryetarit dhe qiramarrësit ku nuk është paguar qiraja gjashtë muaj përpara, mirëpo lidhur me këtë kontratë ka shkelje edhe sa i përket ndarjes së asaj parcele për të cilën thuhet se nuk ka të drejtë të ndahet dhe të tjetërsohet, por në fakt ajo pronë edhe është ndarë edhe është tjetërsuar ku prej një objekti të dhënë me qira tani janë dy objekte relevante ekzistuese të cilat e ushtrojnë biznesin e tyre dhe kush e merr qiranë e dinë vetëm ata të cilët e kanë nënshkruar kontratën përkatëse dhe ata që e kanë lëshuar me qira. Çështje tjetër që dua të ceku është edhe objekti tjetër në pronësi komunale i cili është përfolur shumë i cili është ish "Hotel Llapi", për të cilin Auditori nuk ka vërejtur shkelje, mirëpo unë si pjesë e atij komisioni kam ngritur zërin edhe më parë sepse ka pasur parregullsi dhe shkelje të rregulloreve, objekti është me një sipërfaqe 816 m² i cili është dhënë në shfrytëzim me një shumë 1180 €, e që kryetari i komisionit drejtpërdrejt bie në kundërshtim me Rregulloren e miratuar në Kuvendin e Komunës në vitin 2010 e cila i specifikon dhënien e pronave në shfrytëzim sipas zonave përkatëse, ky objekt gjendet në zonën e parë ku me Rregulloren parashihet 3 € për m², mirëpo në këtë rast është cilësuar si kur të ishte në zonën e tretë dhe nuk i bie as 1 € të plotë për m², andaj nëse e kalkulojmë sipas Rregullores përkatëse, në 816 m² nga 3 € për m² i bie 2,448.00 €, kurse ai objekt është dhënë në shfrytëzim për vetëm 1180 €, pra edhe kjo është një shkelje e Rregullores së Kuvendit. Ne si komision për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim jemi marr vetëm me tri prona deri tani, kurse të gjitha pronat tjera që u përmenden nga parafolësit ne si komision nuk jemi marr asnjëherë, do të thotë se Ekzekutivi i Komunës jep prona në shfrytëzim pa iu nënshtruar Kuvendit të Komunës dhe komisionit përkatës.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, fillimisht në emër të Kryetarit të Komunës falënderoj Ekzekutivin e Komunës për një punë të mirë që ka bërë dhe e cila pasqyrohet edhe në raportin e Auditorit të përgjithshëm. Ndoshta ne do të duhej që më tepër të fokusohemi te çështjet e theksuara në raportin e Auditorit se sa të përpiqemi ta ndërrojmë opinionin e Auditorit, gjë e cila nuk mund të bëhet, sepse është një opinion i dhënë nga Auditori i Përgjithshëm, na pëlqen apo jo, ai është, opinion i modifikuar apo siç quhet ndryshe, i pakualifikuar, dhe këtu nuk mund të japim dyshime hipotetike se a është i besueshëm ky raport dhe çfarë mostrash ka përzgjedh, pra është opinion i caktuar, por do të duhej që të gjithë, si këshilltarët e Kuvendit ashtu edhe Ekzekutivi i Komunës të fokusohemi që në gjashtëmujorin e dytë dhe në vitin në vijim të përmirësojmë dhe të eliminojmë të gjitha ato çështje të cilat janë me theks nga Auditori i Përgjithshëm.

Nga disa parafolës u shtruan disa çështje, ku ndër të tjera u tha se Ekzekutivi i Komunës e ka për detyrë të lavdëroj vetën, gjë për të cilën mendoj se e njëjta gjë është edhe për opozitën e cila e ka për detyrë të sulmoj pozitën, andaj këto çështje më shumë janë çështje retorike se sa çështje me të cilat duhet të merremi. Unë besoj në vullnetin e mirë të secilit prej jush çoftë nga Ekzekutivi i Komunës çoftë nga Kuvendi, që aty ku është mirë të themi se është mirë, dhe aty ku duhet përmirësuar bashkërisht t'i bashkojmë forcat dhe ta përmirësojmë, sepse në fund të fundit të gjithë ne këtu jemi për të mirën e qytetarëve. U ceken edhe disa çështje për të cilat nuk do të dëshiroj të merrem me secilën pyetje veç e veç në mënyrë që mos shkaktohen replika të panevojshme, sepse nuk jam i interesuar për këtë gjë, mirëpo u cekën disa çështje të cilat më duhet të jap sqarime në mënyrë që të mos krijohet ndonjë huti dhe të dalim nga kjo sall pa u sqaruar mirë. U tha se 16,000.00 € nga Komuna iu kanë transferuar kompanisë IOM, sqarim IOM nuk është kompani, por është Organizatë dhe në rastin tonë është donatorë i një projekti, po ashtu edhe me procedura të prokurimit, në rastet e bashkëfinancimit, kur njëri donatorë ka shumën mbi 51% të mjeteve të investuara në një projekt atëherë ai operatorë i udhëheqë edhe procedurat e prokurimit, pastaj për t'i udhëhequr ato procedura duhet të zotohen mjete buxhetore, ne kemi aplikuar me një projekt në IOM ku fatmirësisht e kemi fituar atë projekt ku shuma e përgjithshme e atij projekti është 118,000.00 € dhe pjesa e participimit të Komunës është rreth 16,000.00 €, pra është dashur të barten mjetet në llogari të Organizatës Botërore të Migrimit – IOM, në mënyrë që të procedohet më tutje me projekt dhe fatmirësisht projekti është në fazën finale ku vërtetë është bërë një punë e mirë dhe që pritet të përfundoj brenda pak ditësh. E përsërisë edhe njëherë se nuk e kam ndërmend të lëshohem në të gjitha detajet që u cekën, por përsëri falënderoj të gjithë Ekzekutivin e Komunës të cilët kanë punuar që ky raport i Auditorit të Përgjithshëm të ketë këtë opinion, mirëpo duke shpresuar që çështjet e theksuara në raport të merren seriozisht në shqyrtim në mënyrë që raporti i ardhshëm që do të bëhet në vitin 2016, për vitin 2015, të ketë me sa më pak çështje të theksuara.

z.Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës, theksoi, dua të jap përgjigje në pyetjen e këshilltarit z.Lutfi Rexhepi rreth shitjes së automjeteve zyrtare, përgjigja iu është dhënë me shkrim, mirëpo edhe njëherë dëshiroj të sqaroj se me rastin e shitjes së automjeteve zyrtare të Komunës janë përfillur të gjitha procedurat e prokurimit publikë që duhet të përfillen për rastin në fjalë, ku fillimisht është bërë vlerësimi i automjeteve, pastaj është bërë konstatimi i gjendjes së tyre, dhe të gjitha procedurat tjera të nevojshme. Ne kemi debatuar për këtë çështje edhe më parë mirëpo meqë u hap kjo temë dua të përsërisë se ato automjete kanë qenë pothuajse totalisht jashtë përdorimit, kanë harxhuar

sasi të madhe të karburanteve, pastaj është vlerësuar që servisimi dhe riparimi i tyre nuk ja vlen të bëhet. Shuma e shitjes së tyre është ajo e cila është vlerësuar me ofertën më të mirë në bazë të Ligjit për prokurimin publik ku janë përfillur të gjitha procedurat e nevojshme, sigurisht se për shitjen të të automjeteve ajo shumë nuk është e kënaqshme mirëpo aq ka ardhur oferta më e madhe. Lidhur me procedurën përkatëse unë paraprakisht jam konsultuar edhe me disa Komuna, por edhe në nivelin Qendrorë. Gjithashtu kamë hasur në praktika të Qeverisë dhe të disa Ministrive të ndryshme të cilat në të njëjtën mënyrë janë liruar nga automjetet zyrtare sikurse që kemi vepruar edhe ne.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, do të mundohem të jap sqarime vetëm në dy-tri çështje, e falënderoj Nënkryetarin e Komunës i cili një çështje tash më e sqaroi. Në çiftë se të gjithë e kanë dëgjuar me vëmendje rezyemenë që e bëra në fjalën hyrëse rreth kësaj pike, sigurisht se vërehet se as nuk jam marrë me lëvdata e as me përqeshje, në pjesën e parë të fjalimit tim shkruan në mënyrë të përgjithshme se çfarë thotë opinioni i Auditorit të Përgjithshëm, pastaj në pjesën e dytë të fjalimit tim prapë e kam cek se çka ka thënë Auditori për vërejtjet të cilat janë cek, do të thotë se as nuk kam lavdëruar e as nuk kam përqeshur unë, por kam bërë një rrumbullakësim të raportit të Auditorit të Përgjithshëm si për anën pozitive ashtu edhe për anën negative, andaj këto janë dy elementet karakteristike që unë i kamë marrë nga raporti. U cek këtu që edhe raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2013 ka qenë opinion i pakualifikuar ose i modifikuar që është një opinion, të shprehem kushtimisht, opinioni më i lartë që mund t'i jepet një organizate buxhetore, dhe ai opinion ka qenë edhe për Komunën e Podujevës, kështu që nuk është Komuna e Podujevës në mesin e Komunave më të dobëta në këtë aspekt por ndoshta është në mesin e Komunave më të mira. Sa i përket, klasifikimit të i shpenzimeve në kode jo adekuate, edhe në mbledhjen e KPF-së e kam thënë se, këtu nuk është përfillur plani kontabël, por çështja ligjore është përfillur në përpikëri, shembull, buxheti i vitit 2014 i aprovuar në këtë Kuvend dhe i cili e ka marr vizën nga Qeveria e Kosovës gjegjësisht nga Ministria e Financave dhe ka shkuar në Kuvendin e Kosovës ku edhe është miratuar dhe me këtë rast është bërë Ligj, dhe ky Ligj është zbatuar ashtu siç miratuar në Kuvendin e Komunës, në Ministri të Financave, në Qeveri të Kosovës dhe në Kuvend të Kosovës, prandaj këto janë ato çështjet që i cek Auditori si klasifikime jo adekuate të shpenzimeve, mallra, shërbime dhe kapitale, bëhet fjalë edhe për dezinfektim, dezinfektim dhe derratizim – DDD, dhe për mirëmbajtjen e parqeve, shesheve dhe hapësirave tjera të qytetit, por megjithatë janë në kuadër të Ligjit të buxhetit të miratuar në Kuvendin e Kosovës për vitin 2014 ku edhe në atë formë janë zbatuar, pra edhe njëherë e përsëris se kemi të bëjmë me kundërshtim të planit kontabël e jo me Ligjin. Lidhur me, regjistrimi i pasurive të Komunës, kemi të bëjmë me pasuri gjegjësisht me rrugë, kanalizime etj, për të cilat pagesat janë kryer deri në ditën e fundit të vitit 2014, dhe kur të bëhen pagesat ai dokument duhet të fotokopjohet dhe të dorëzohet në zyrën e regjistrimit të pasurive ku më 31 dhjetor të vitit mbyllet sistemi i free-balanc, dhe nuk mund të regjistrohen ato pasuri në atë vit por megjithatë ato pasuri regjistrohen në vitin pasues dhe nuk ka kurrfarë rreziku që rrugët, kanalizimet dhe objektet tjera që kanë qenë pjesë e pagesave, të tjetërsohen apo të humbin, kështu që të gjitha ato janë të regjistruara në pasqyrat e vitit 2015. Rreth asaj që u cek lidhur me raportimet e drejtorëve të Kryetari i Komunës, unë ju them se në aspektin juridik kjo çështje nuk është e definuar, por realisht të gjithë Drejtorët raportojmë dhe e informojmë Kryetarin për punët dhe aktivitetet tona për secilën Drejtori, ndërsa çështjen rreth mënyrës së raportimit në bazë

të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore e përcakton vetë Kryetari i Komunës, pra konsideroj se nuk ka shkelje ligjore sa i përket kësaj çështjeje. Do të thotë ne i raportojmë Kryetarit të Komunës por raportimet i dërgohen edhe Ministrit të Ministrisë së Financave dhe janë publike, andaj në raport të Auditorit nuk thuhet se janë shkelur dispozita ligjore. Lidhur me atë që u cekë nga këshilltari nga radhët e LVV-së i cili është edhe pjesë e komisionit përkatës, rreth dhënies në shfrytëzim të objektit ish "Hotel Llapi", unë mendoj se komisioni fillimisht ka debatuar se në atë rast është zbatuar edhe Ligji edhe Rregullorja përkatëse, kështu që fuçi më të madhe ka Ligji sesa Rregullorja, pra kur një Ligj hynë në fuçi, aktet apo dispozitat e akteve tjera që janë në kundërshtim me atë ligj nuk mund të zbatohen, por duhet të zbatohen dispozitat e Ligjit, andaj në këtë rast konkretisht ky Kuvend ka marr Vendim që ai objekt të del në ankand publik, ky Kuvend ka marr vendim që të formoj një komision për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, i cili ka për detyrë të merret me procedurat përkatëse, në atë ankand publik kanë konkurruar ofertues të ndryshëm dhe ofertat janë ato që e përcaktojnë çmimin e dhënies në shfrytëzim e jo Rregullorja, kështu që besoj se ai objekt është dhënë në shfrytëzim në bazë të Ligjit përkatës e jo në bazë të rregullores, andaj përderisa ekziston Ligji, aktet tjera, nëse janë në kundërshtim, nuk zbatohen.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Administratës për sqarimet, mirëpo unë nuk e kontestova nevojën e shitjes së atyre automjeteve, nuk e kontestova as çmimin e tyre që i bie rreth 370 € një veturë mjete të cilat do të mund të merreshin edhe në qoftë se t'i dërgonit në skrap, por unë vetëm shtrova si dilemë, dhe e thash se ligjin nuk e kam lexuar por i kontaktuar personat e kësaj fushe të cilët më kanë thënë se Komuna nuk ka të drejtë të shes pasuri pa vendim të Kuvendit, andaj në qoftë se është ashtu siç jam i informuar e thash se puna është keq, pra nuk e kontestova nevojën apo çmimin. Çështja tjetër, ka të bëjë me atë që Nënkryetari i Komunës e tha rreth raporteve pozitive-opozitive, i them Nënkryetarit që roli i opozitës nuk është vetëm të kritikoj por është që t'i qes në pah të metat e Ekzekutivit, sepse kjo është në natyrën e Ekzekutivit që në mënyrë afirmative t'i përmend të arriturat kurse i harron pak sa ato gjëra që është dashtë t'i bëjë dhe që nuk i ka bërë, prandaj është edhe roli im që t'i përkujtoj edhe këto gjëra që nuk janë bërë dhe që u dashtë t'i bëjë.

z.Bahri Selimi, theksoi, më vie keq që më duhet të replikoj tani kur drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili posa doli nga salla, por unë desha vetëm t'i falënderohem për sqarimet e ligjit që i bëri dhe njëkohësisht desha t'i tregoj se e njohim edhe ne ligjin dhe jemi në dijeni se çka është ligji dhe çka është rregullorja dhe cili është akt më i lart dhe cili më i ultë. Ligji për të cilin foli drejtori nuk e specifikon dhe nuk i ndan zonat në Komunën e Podujevës dhe në asnjë Komunë tjetër, por ligji e jep mundësin që duke u bazuar në atë Komuna të nxjerrin Rregullore në të cilën specifikohen zonat dhe caktimi i vlerës së tyre, pra ligji nuk e cakton çmimin e zonave brenda Komunave, por këtë e përcakton Rregullorja e nxjerrë në bazë të atij ligji. Në rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës përkatëse nuk është bazuar në asnjë ligj sepse në asnjë ligj nuk caktohet shuma e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

z.Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, lidhur me atë që z.Rafet Llapashticës pyeti se, sa punëtorë ka në sektorin e shëndetësisë të cilët janë të punësuar me kontratë mbi vepër dhe sa prej tyre janë të punësuar më shumë se gjashtë muaj, përgjigja është se duke pasur parasysh se është rritur numri i ambulanteve shëndetësore dhe numri i madh i pacientëve të cilët kërkojnë shërbime

mjekësore në të gjitha këto ambulante, dhe duke pasur parasysh numrin e kufizuar të punëtorëve shëndetësorë, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka 5 punëtorë të punësuar me kontratë mbi vepër të cilët janë në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj. Sa i përket asaj që z.Haki Rudari e ceku çështjen e pagesës gjatë pushimit të lehonisë të një punëtoreje të shëndetësisë, nuk qëndron ajo që zotëri Rudari e tha se punëtorja e ka marrë pagën e plotë për një vit, por faktikisht është paguar me 70% të pagës sipas raportit të Auditimit, ne e kemi identifikuar rastin dhe i kemi dërguar ndryshimet në Ministrinë përkatëse dhe faktikisht sikurse në të gjitha ndryshimet tjera në 70% të pagës për gjashtë muaj dhe njëkohësisht me 50% të pagës për tre muaj të tjerë që i kompenson Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Nënkryetari i Komunës e the se ne duhet t'i besojmë raportit të Auditimit të Përgjithshëm i cili është një dokument i drejtë, unë e them se i besojmë këtij raporti dhe mendojmë se të dhënat në këtë raport janë reale, sa i përket çështjes së ndërlidhur me Organizatën IOM, është evidente se në raport figuron kjo e gjetur nga Auditori dhe natyrisht se unë po besoj se janë paguar 16,000,00 € në vitin 2014 për një kontratë sipas së cilës punët kanë filluar në muajin mars 2015 për një projekt i cili nuk ka qenë projekt prioritarë por është fituar donacion dhe nuk ka pasur nevojë të bëhet barrë buxhetore për tu bartur mjetet buxhetore gjashtë muaj përpara, gjë për të cilën mendoj se në këtë rast as nuk është respektuar Ligji prokurimit, as vendim i Kuvendit dhe as nuk është respektuar si nevojë e Drejtorisë së Arsimit, madje Nënkryetari ka qenë edhe drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe është në dijeni shumë mirë për gjendjen e Arsimit në Komunën e Podujevës, andaj unë i besoj këtij raporti bartja e mjeteve buxhetore nga Komuna në organizatën IOM është e gjetur e Auditorit dhe unë dua t'i besoj kësaj madje edhe më shumë se vetë Nënkryetari i Komunës sepse kjo gjendje është shumë reale. Çështje tjetër që u përmend është edhe prona publike komunale, unë e pyes Nënkryetarin e Komunës, kush i jep të drejtën një personi publik që të heq nga prona publike një pronë komunale, pra ai është drejtor i një Drejtorie të Komunës së Podujevës i cili i ka hequr dy prona publike nga lista e pronave komunale, dhe pyetja tjetër, si mund të ankohet drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mungesë të mjeteve buxhetore, kur prona komunale hiqet nga lista e pronave të dhëna në shfrytëzim dhe nga ajo pronë nuk gjenerohen mjetet, kurse nga ajo pronë dikujt tjetër i paguhen mjete, unë i përmenda vetëm dy prona të tilla por e them se janë dhjetë të tilla, andaj Nënkryetari i Komunës mund të angazhon drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit të del në terren dhe të merren me këto çështje. Meqë prezent janë edhe mediat në këtë sallë unë dua të ngris edhe çështjen që ka të bëjë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, ish "Banka për Biznes" në qendër të qytetit – zona 1 për të cilën i lus mediat që të marrin incizimin e atij objekti për të cilin tarifat janë caktuar nga vetë subjekti në pushtet, objekt i cili është ndarë në dy pjesë dhe funksionojnë dy biznese ku për njërin Komuna inkason qiranë, kurse qiranë për pjesën tjetër të ndarë të lokalit nuk jam në dijeni se kush e inkason, gjë për të cilën pyes Nënkryetarin e Komunës, drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit që të tregojnë nëse kanë dijeni se kush e inkason qiranë e objektit të ndarë, pra këto janë pyetje për të cilat nuk dëshirojmë të kemi debat por kërkojmë përgjigje. Lidhur me përgjigjen e drejtorit të Drejtorisë së Administratës rreth shitjes së automjeteve zyrtare të Komunës, unë mendoj se drejtori e ka zbatuar ligjin e prokurimit, mirëpo për të shpallur në ofertë të hapur është e obligueshme të zbatohet ligji për pushtetin lokal dhe nëse ky ligj jep të drejtë të procedohet me ligj të prokurimit atëherë mund të zbatohet ligji i

prokurimit, pra prona publike nuk guxon të tjetërsohet e as të shitet pa vendim të Kuvendit të Komunës, kurse janë shitur 8 automjete pa vendim të Kuvendit me një çmim rreth 250 € për copë, pra mendoj se përgjigja e drejtorit nuk është adekuate.

z.Haki Rudari, theksoi, u tha se po bëhen përpjekje të ndërrohet opinionimi i dhënë në këtë raport, unë nuk mendoj se jemi duke bërë ndërrim të opinionit sepse ne jemi duke debatuar sipas raportit të Auditimit, të gjitha ato që unë i lexova janë në raport të Auditimit të Përgjithshëm, nëse ka ndonjë që e kam shtuar unë jap përgjegjësi. Në faqe 6 të raportit thuhet, menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e Auditimit dhe është zotuar se do ti adreson rekomandimet tona, pra të gjithë ato janë në kuadër të auditimit. Çështje tjetër, drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e tha se janë më shumë se pesë persona që punojnë me kontratë mbi vepër në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj, ndërsa unë e them se auditori ka gjetur edhe shkelje të ligjit për shërbimin civil i cili në nenin 12.4 thotë, kontrata duhet të jetë më e shkurtër se gjashtë muaj, dhe në rast se ka të punësuar më shumë se gjashtë muaj sigurisht se është shkelje e ligjit, pra ne nuk jemi duke bërë ndërrim të opinionit por jemi duke cekur shkeljet që janë bërë dhe duke paraqitur realitetin ekzistues. Sa i përket çështjes së Auditimit të Brendshëm, ndër të tjera thuhet, ishte përmbushur plani i punës rreth 90% por nuk ishte kryer auditim në fushën e prokurimit kur dihet se kjo fushë është me rrezik të lartë, andaj pyes Ekzekutivin e Komunës, përse nuk është kryer auditimi i brendshëm në fushën e prokurimit. Gjithashtu rekomandimi numër 15 për Kryetarin e Komunës është, gjithashtu ndër të tjera duhet të aktivizohet Komiteti i Auditimit. Pra të nderuar koleg këto janë të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm të cilat janë në raport.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, raporti i Auditimit të përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës për vitin 2014 është raport publik në të cilin ka qasje çdo qytetarë dhe për të cilin secili që nuk është mirë i informuar mund të konsultohet edhe me auditor të kësaj fushe në mënyrë që të vlerësohet në përmbajtja e përgjithshme e opinionit të dhënë në raport.

U përmend emri i një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, andaj me qëllim të realitetit, unë dua të jap një sqarim ngase kam qenë edhe në përbërje të Ekzekutivit të Komunës në kohën kur është dhënë në shfrytëzim prona përkatëse, objekti në fshatin Orllan nuk iu është dhënë në shfrytëzim z.Nuredin Ibishit por iu është dhënë Naim Ibishit në kohën kur në Komunën e Podujevës ka qeverisë Administratori komunal, kurse sa i përket pagesa unë sa jam në dijeni ajo është bërë pjesërisht por që nuk është kryer në tërësi dhe ai obligim ndaj komunës ekziston ende kurse Komuna sigurisht se do të gjej mënyra për inkasimin e atij borxhi të mbetur nga Naim Ibishi.

4. Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2015

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht se materialin e keni marrë me kohë, do të dëshiroja të jemi më transparent dhe gjërat që u përmendën në pikën paraprake të mos ngatërrohen me këtë pikë, por nëse keni vërejtje apo sugjerime ato mund t'i paraqitni. Para se të hapi debatin fjalën ja jap drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për një fjalë hyrëse rreth këtij raporti.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse, ku ndër të tjera veçoi, ju bëjë apel qytetarëve dhe bizneseve t'i kryejnë obligimet e tyre ndaj Komunës në mënyrë që të kenë një ambient më të përshtatshëm për jetë dhe bizneset të kenë kushte më të mira për të zhvilluar biznes, po ashtu konstatimi im është se raporti paraqet pasqyra të qarta të të hyrave dhe të të dalave të Komunës për periudhën përkatëse duke përmendur shifra konkrete dhe krahasime me periudhën e vitin paraprak.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, konsideroj se raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-qershor 2015 profesionalisht është përgatitur mirë, pasqyron shumë mirë pasqyrat financiare për periudhën përkatëse si dhe është paraqitur brenda afatit ligjor. Po ashtu gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore një sërë projektesh janë duke u realizuar në nivel Komune nga operatorë të ndryshëm ekonomik gjë e cila sigurisht se ndikon në zhvillimin ekonomik të Komunës tonë. Pra para vetës kemi një raport pozitiv i cili argumenton punën e madhe që e ka bërë dhe që vazhdon ta bëjë Kryetari i Komunës së Podujevës dhe Ekzekutivi i Komunës në përgjithësi në funksion të ngritjes së standardit të qytetarëve të Komunës së Podujevës.

z.Flakron Gashi, theksoi, *në emër të Grupit të këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës*, theksoi, është mirë që jemi duke jetuar në një shoqëri ku ligji e mundëson qasjen në të gjitha dokumentet zyrtare, dhe që çdo Komunë dhe çdo institucion e ka edhe vartësin e tij që duhet të raporton. Raporti financiar janar-qershor është i mangët dhe sipërfaqësor dhe është vështirë i zbërthyeshem dhe i kuptueshem ngase krijohet dhe hartohet si i tillë që mangësitë eventuale të kalohen pa u vërejtur madje duke krijuar huti të dy palët e asamblistëve, pozitës dhe opozitës. Ky raport paraqet një gjendje jo të mirë të qeverisjes madje dhe mund të zbërthesh keqpërdorime dhe shkelje të shumta, dhe në vazhdim unë po i paraqesë disa prej tyre.

Në këtë raport janë deklaruar shpenzime në vlerë prej 13,354.00 € për mëditje, akomodime, udhëtime dhe shpenzime të tjera jashtë vendit, ndërsa në realitet janë shpenzuar plotë 23,644.00 € apo për 56.47% më e lartë se ajo që ju keni deklaruar, këtu hyjnë edhe avanset që janë dhënë për udhëtime jashtë vendit. Në DPZ visari, vetëm në muajin mars dhe prill janë paguar fatura në vlerë 334 € për larjen e autoambulancave, duke qenë në dijeni se QKMF në Podujevë ka 2 apo 3 të tilla, unë mund të kem informacion të gabuar por mendoj se kaq janë, ose çmimi për larjen e një autoambulance qenka tmerrësisht i lartë, ose prapa kësaj fshihet diçka tjetër. Komuna ka paguar në emër të pastrimit të rrugëve, KRM "Pastrimi" shumë prej 2,677.71 € në periudhën kohore të dimrit ku temperaturat ishin madje deri në minus 17 C, dhe nuk e di si pastrohen rrugët me ujë në atë kohë, ose Komuna ka dashtë t'i shndërroi rrugët në plato patinazhi, ose prapa kësaj fshihet diçka tjetër. Është për tu theksuar që në dy ndërmarrjet private, Rita dhe Fusha, Komuna ka paguar vlera, respektivisht tek ajo e para mbi 30,000.00 €, kurse tek e dyta përafërsisht 10,000.00 €, ku më bie në sy një pagesë e cila është bërë në NTP Fusha në vlerë 3,380.00 € për të cilën ceket se kjo pagesë është bërë për furnizim me tekste shkollore për Komunitetin ashkalinj, ne jemi të vetëdijshëm se furnizimin me tekste shkollore në të gjitha shkollat fillore në nivel vendi e bënë Qeveria e Republikës së Kosovës, dhe atë pa pagesë, dhe unë jam në dijeni se edhe Komuniteti ashkalinj mëson me të njëjtat kurrikula si në Komunën tonë ashtu edhe në nivel vendi, apo të paktën në Komunën tonë nuk kanë ndonjë program të tyre të cilin e zhvillojnë, andaj pyes çfarë i bënë të veçanta për Komunën e Podujevës këto dy biznese, Rita dhe Fusha, madje dhe çmimet e materialeve të kontraktuara a janë në nivel me çmimet e tregut apo prapa kësaj

fshihet edhe diçka tjetër. Të nderuar, pozitë – opozitë, drekat dhe darkat janë glamuroze dhe për të njëjtat shpenzimet janë marramendëse, ka raste kur një drekë kushton nga 400 – 500 €, deri në 1,400.00 € janë paguar vetëm për një drekë në vendet e preferuara, “Adriatik” dhe “Milleniumi 2000” , madje “Adriatiku” i është paguar faturë edhe për shpenzime telefonike në vlerë 309 €, informacion të cilin e mora nga ky raport sepse deri tani nuk kam qenë në dijeni se “Adriatiku” kryen edhe shërbime postale. Në raport është deklaruar si shpenzim në kodin buxhetor 11400 shuma 1,739.00 € për pagesa të punëtorëve me kontratë, jo në listën e pagave, por e vërteta është më ndryshe dhe në fakt Komunës i ka kushtuar kjo kategori e punëtorëve hiq më pak se 18,695.00 € për periudhën janar-maj 2015, dhe pyes, me çfarë kontratash mbahen në punë këta punëtorë, me qenë se nuk janë në listën e pagave, dhe a është fjala për të njëjtin rast që ceket edhe në raportin e Auditimit të Përgjithshëm për shkeljet e Ligjit për shërbimin civil, pra respektivisht ata persona prapë marrin pagat e njëjta që kanë qenë edhe në vitin 2014. Çështja tjetër ka të bëjë me lëndën drusore ose dru për ngrohje e që operatorit ekonomik “Bushgegu” i është paguar shuma 91,589.10 €, dhe kjo shumë po të zbërthehet, e që në Podujevë 1m³ dru kushton përafërsisht 30 €, sipas jush kjo na tregon se keni siguruar rreth 2700 m³ dru, apo nëse e përpjesëtojmë me numrin e shkollave, pasi që janë institucionet që kryesisht si lëndë djegëse përdorin drurin, duke përjashtuar disa shkolla të mesme dhe të qytetit, i bie që rreth 40 shkolla fillore kanë shpenzuar nga 65 m³ dru, kurse sipas informatave nga disa drejtorë të këtyre shkollave, sidomos të vendeve rurale, kjo nuk qëndron as përafërsisht me atë që është deklaruar, dhe unë pyes çfarë fshihet pas kësaj të nderuar, në interesat e kujt prek kjo, dhe sa është paguar një m³ dru në Podujevë, gjegjësisht mos të harrojmë faktin se në vitin e kaluar e gjithë hapësira ose parku i Ujësjellësit i cili gjendet në rrugën Podujevë-Peran ka qenë i mbushur me qindra metra dru, apo ndoshta ka kontraktuar të njëjtat dru kompania “Bushgegu” , apo kujt u janë dhënë ato dru. Për derivate janë shpenzuar 37,919.00 €, dhe jo e gjitha është shpenzuar vetëm për qëllime zyrtare por një pjesë e tyre edhe për nevoja personale. Gjithashtu në emër të shpenzimeve, vendime të Gjykatave, kodi 14410, është paraqitur shuma 14,460.2 €, kurse në realitet kjo shumë do të duhej të paraqitej si pagesa në bazë të vendimeve gjyqësore ku realisht shuma është më e lartë, pra bëhet fjalë për 22,104.00 €, shuma prej 7,663.8 € i është paguar PTK-së në bazë të Ligjit nr.03/L-048 për financat publike dhe përgjegjësit, dhe drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave si ekspert i kësaj fushe është në dijeni se në nenin 39 pika 2, thuhet që Komuna si borxhli e keqe kur nuk i ekzekuton një operatori paratë të cilat i meriton, operatori bënë kërkesë në thesar dhe Komuna është e obliguar t’ia paguaj borxhin. Çështja tjetër, ne kemi dëgjuar opinione të ndryshme për vendime dhe tërheqje nga vendimet ku Komuna në muajin mars të këtij viti ka marrë vendim për eliminimin e qenve endacakë dhe ka bërë një marrëveshje me Shoqatën e Gjahtarëve “Llapi” nëse nuk gabohem, në marrëveshja ka qenë që të paguhet 17 € kostoja për eliminimin e një qeni, por mandej Komuna prapë është tërhequr nga ai vendim, por e vërteta është se kësaj Shoqate në llogari i janë bartur 2,227.00 €, që po të zbërthejmë me atë që për eliminimin e një qeni Komuna ka arritur marrëveshje në shumë prej 17.00 €, ajo Shoqatë do të duhej të eliminonte 131 qenë, për këtë vetë udhëheqësi i kësaj Shoqata ka deklaruar se sa jam më dijeni janë eliminuar rreth 7-8 qenë, pra është mirë të sqarohemi, në qoftë se një Shoqate të Gjahtarëve për eliminimin e qenve endacak i barten në llogari 2,227.00 €, ndërsa Shoqatës së të Shurdhërve i bartet një shumë simbolike prej 150 €, kjo vërtetë është shaka. Komuna

sipas këtij raporti ka arritur që për gjashtë muajt e parë të vitit të realizoj vetëm 35% të të hyrave vetanake të parapara në vlerë prej 1,597,592.00 €, dhe nëse vazhdohet me këtë ritëm shumë projekte të parapara për këtë vit do të mbeten pa u realizuar. Duhet të ceket se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, gjithë buxhetin e paraparë për këtë vit e kanë nga të hyrat vetanake, kurse Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit mbi 70% të buxhetit të paraparë e ka të varur nga kjo kategori, andaj nëse Komuna vazhdon me këtë ritëm të të hyrave vetanake, një numër i madh i projekteve të parapara nga këto tri Drejtori do të mbesin pa u realizuar.

z.Bahri Selimi, theksoi, në Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e kemi analizuar këtë raport i cili pothuajse ka probleme të njëjta me raportet financiare të viteve të kaluara, mirëpo kemi arritur që t'i nxjerrim disa çështje të cilat i kemi vërejtur se nuk janë pajtim me interesat e qytetarëve. Fillimisht dua të ndalem te shpenzimet sipas kodeve që më bënë shumë përshtypje, mëditjet dhe udhëtimet jashtë vendit, ku kemi një rritje shumë të madhe prej 310%, apo saktësisht janë 4,226.00 €, mirëpo ka edhe shpenzime tjera për udhëtime jashtë vendit në shumë 2,764.00 €, madje shpenzime tjera nga të hyrat vetanake në shumë 739 €, e që shpenzime për udhëtime zyrtare jashtë vendit gjithsejtë i bie të jenë 7,729.00 €, dhe për këtë kam pyetje konkrete për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, sa ka arritur Komuna e Podujevës që nga këto udhëtime jashtë vendit të sjellë investime ose donacione nga jashtë, apo këto udhëtime janë bërë vetëm për interesa partiake siç kemi rastin e fundit të udhëtimit në Gjermani të Kryeministrit z.Isa Mustafa i cili pa qenë fare pjesë e protokollit merr me vete edhe z.Agim Velin dhe z.Lutfi Hazirin, apo ndoshta Komuna nuk është duke ditur ku t'i investoi shumë mjete buxhetore, apo ndoshta i paguajmë edhe udhëtimet e Qeverisë. Gjithashtu shumë përshtypje më ka bërë dhe më bënë një çështje e cila gjithherë është e njëjtë, e cila ka të bëjë me, pajisje tjera në vlerë deri në 1000 €, për të cilat aspak nuk jemi në dijeni se çka është blerë me ato mjete dhe çka janë ato pajisje, dhe nëse janë nën vlerën 1000 €, i bie që në 8,859.00€ janë blerë mbi dhjetë pajisje, dhe pyes, a ja vlen të blihen mbi dhjetë pajisje dhe të mos specifikohen në raport, apo kjo përdoret si mbulesë e të metave tjera të raportit financiar. Sa i përket mirëmbajtjes së shkollave, është një rritje shumë e madhe, gjë për të cilën u ndjeva mirë dhe i gëzohem faktit që ka filluar mirëmbajtja dhe renovimi i objekteve shkollore sepse jemi në dijeni se në çfarë gjendje kemi shkollat tona, madje unë kam dy fëmijë dhe shpeshherë vizitoj shkollën në të cilën vijnë shkollimin ata, shkollë në të cilën kundërmimi nga erërat e ndryshme është i madh. Sa i përket pagesave të përfituesve individual, kam pyetje dhe dëshiroj të marrë përgjigje për këtë, a ekziston mundësia të sqarohemi më shumë rreth kësaj sepse kemi të bëjmë me një shumë prej 48,000.00 € dhe nuk jemi në dijeni se për këndë bëhet fjalë. Gjithashtu prapë kemi të bëjmë me pagesë në vlerë 48,000.00 € për, pajisje tjera, shumë e cila si duket janë imtësi për Komunën sepse nuk specifikohet se çka është blerë dhe çka janë ato pajisje tjera, dhe për këtë gjithashtu kërkoj përgjigje sepse në çdo raport figuron kjo, pajisje tjera, pa qenë në dijeni se për çfarë pajisjesh është fjala. Pastaj kam vërejtur edhe subvencione në vlerë 140,000.00 €, për entitete jo publike, prapë nuk e kam të qartë çka do të thotë kjo. Po ashtu për pagesat, kapital tjetër, kërkoj sqarime ngase gjithherë vetëm përmenden dhe nuk specifikohen se për çfarë bëhet fjalë, vërtetë kam dyshime se çka munden me qenë këto kategori, si pajisje tjera, kapital tjetër e të ngjashme sepse asnjëherë nuk kemi specifikime dhe shpresoj të marrë përgjigjet dhe sqarimet e nevojshme.

z.Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, theksoi, në fakt fjalën e morra si ish drejtor i Drejtorisë së Arsimit, me qëllim që të jap sqarime rreth dy shqetësimeve të ngritura nga këshilltari z.Flakron Gashi. Lidhur me tekstet shkollore të komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptas, të paguara në vlerë mbi 3,000.00 €, kjo nuk ka ndodhur vetëm këtë vit por është duke ndodhur për gjashtë vite me radhë dhe do të vazhdohet prapë të paguhen tekstet për nxënës të Komunitetit rom ashkalinj dhe egjiptas, por fjala është për tekste të nivelit të shkollës së mesme të lartë, tekste të cilat nuk subvencionohen nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, andaj me qëllim të stimulimit dhe motivimit të nxënësve të atyre komuniteteve për të vijuar shkollimin e mesëm të lartë ne kemi financuar tekstet dhe do të vazhdojmë të financojmë. Sa i përket lëndës drusore për shkolla, rreth çmimit nuk dua të merrem sepse atë e përcakton tregu përmes ofertës së hapur publike, ndërsa këshilltari i cekur përmendi 40 shkolla, në fakt janë 41 institucione arsimore mirëpo janë 67 objekte shkollore, sepse ka shkolla të cilat i kanë nga tri objekte ose paralele të ndara, shembull kemi shkollën e fshatit Batllavë ku janë tri objekte mirëpo pagesa evidentohet vetëm për një shkollë kurse faktikisht ekzistojnë tri objekte shkollore. Pra fjala është për 67 objekte shkollore ku rreth 60 prej tyre ngrohjen e sigurojnë me dru, dhe marrë parasysh shpenzimet atëherë nuk rezulton ndonjë shpenzim i madh, mesatarisht rreth 40 metra hapësinore dru për një objekt shkollor, kur kemi parasysh faktin që neve në shtëpi private sigurisht se na duhen të paktën nga 10 metra, pra nuk është ndonjë shpenzim shumë i madh i lëndës drusore për shkolla, kurse sa i përket çmimit të tyre kemi të bëjmë me diçka tjetër.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e ndjeva të nevojshme të sqarohemi në tri pika. U cek pagesa e punëtorëve të cilët nuk janë listën e pagave, fjala është me një donatorë me Komisionin Evropian i cili ka të punësuar dy persona, njëri menaxher dhe një punëtorë tjetër në staf, dhe pagat e tyre paguhen në këtë fond kurse raportohen si të tilla dhe nuk janë në listën e rregullt të pagave por që figuron ai shpenzim. Lidhur me pagesën për përfituesit individual në shumë 48,000.00 € që u cek më parë, konkretisht kemi të bëjmë me bursa për nxënës të shkollave të mesme dhe studentë, kurse rreth përfituesve të entiteteve jo publike kemi të bëjmë me subvencionet që ndahen nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në projekte të cilat janë miratuar në këtë Kuvend për të cilat pagesat bëhen në këtë kod.

z.Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e KPF-së kemi debatuar për raportin financiar janar-qershor 2015, dhe ajo që më ka bërë përshtypje është përqindja e ulët e investimeve kapitale ku nga shuma prej 5,228,275.00 € janë investuar vetëm 698,809.00€ apo shprehur në përqindje i bie 13.36%, dhe për këtë duke pasur për bazë kërkesat e shumta të qytetarëve në lokalitete dhe vende të ndryshme mendoj se është një përqindje shumë e ulët e investimeve dhe konsideroj se këtë çështje duhet marrë për bazë shumë Ekzekutivi i Komunës në mënyrë që të rritet përqindja e shpenzimeve por njëkohësisht të merren për bazë edhe projektet që janë në interes. Përshtypje tjetër në këtë raport, më ka bërë edhe çështja që ka të bëjë me mbeturinat, edhe pse kemi zvogëlim të përqindjes nga viti paraprak, kemi rritje të mbeturinave ose të deponive të egra, andaj marrë parasysh këtë vapë është mirë që Drejtoria përkatëse të ketë parasysh më shumë këtë çështje sepse kemi ankesa të shumta nga vendet urbane dhe nga ato rurale sa i përket deponive të egra. Sa i përket shpenzimit për derivate për gjenerator, nga shuma 1,951.00 € kemi një rritje në 6,929.23 € apo shprehur në përqindje i bie 255.12%, gjithashtu u përmend edhe mirëmbajtja e shkollave, e cila mendoj se është

shumë mirë që është bërë, por mendoj se është mirë të specifikohet se cilat shkolla janë mirëmbajtur, pra të mos thuhet në raport vetëm ad-hoc mirëmbajtja e shkollave dhe kaq, por të specifikohet cilat shkolla, vërejtje e cila është edhe në raportin e Auditimit. Meqë jam punëtorë i arsimit, ju them se kemi ankesa të shumta dhe në shkollën ku unë punoj nxënësit luajnë futboll sikurse para 40-50 viteve, do të thotë nuk kanë fushë të futbollit dhe nuk e di se a është në rregull kjo. Çështje tjetër që dua të them ka të bëjë me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku janë 20,000.00 € shpenzime në emër të dezinfektimit, derratizimit dhe dezinsektimit, dhe pyes, a ka filluar faza e dezinfektimit, nëse po e them se nuk ka pasur njoftime zyrtare dhe jam informuar se në shtëpinë e shëndetit është bërë dezinfektimi në kohën kur punëtorët kanë qenë duke punuar gjë e cila është jashtë normales dhe në kundërshtim me ligjin për arsye se në raste të tilla duhet të kemi njoftime zyrtare në mënyrë që qytetarët t'i mbyllin dritaret për t'iu shmangur lëvizjeve të shumta të insekteve gjatë këtij procesi dhe për këtë kërkoj përgjigje. Sa i përket të të hyrave vetanake të Komunës, në krahasim me vitin paraprak ka një zvogëlim për të cilën mendoj se është një çështje shumë serioze me të cilën duhet të merret Ekzekutivi i Komunës.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, fillimisht në formë të pyetjes dua të shtroj një shqetësim i cili po na përsëritet në vazhdimësi, në gjashtë muajt e parë të vitit kemi realizimin e investimeve vetëm 13% kurse për gjashtëmujorin tjetër mbasin 87%, dhe pyes, përse ndodhë kjo kështu kur kemi parasysh që Ekzekutivi i Komunës i ka projektet e planifikuara dhe të aprovuara, përse nuk fillohet me kohë realizimi i tyre. Çështja tjetër është po ashtu në formë të pyetjes për Kryetarin e Komunës por ai nuk është prezent këtu, atëherë për drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, përse nuk realizohen projektet e propozuara nga Ekzekutivi dhe të miratuara nga ky Kuvend, por zakonisht realizohen projekte të pa miratuara nga Kuvendi, e them këtë ngase ky Kuvend çdoherë i miraton propozimet e Ekzekutivit, ndërsa është vetë Ekzekutivi ai i cili nuk i realizon ato propozime por bënë devijime të tyre, siç është rasti në fshatin Llugë rruga e lagjes Zhitia e cila sa herë merr miratimin nga ky Kuvend por që devijohet për rrugë të lagjeve tjera.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, dëshiroj të ndalem në disa çështje për të cilat kërkohet sqarim, siç janë; shërbime të ndryshme interne dhe këshillëdhënëse në shumë 567.00 €, interesimi jonë është për çka këto shërbime, pastaj furnizim për zyre, një shumë e madhe kur jemi në dijeni se kohëve të fundit asnjë zyrë nuk hapur, kështu që përse kjo shumë kaq e madhe, mandej, furnizime mjekësore në vitin 2014 në një shumë 980.00 € ne duhet të jemi në dijeni për çka janë shpenzuar këto mjete, shpenzime për vaj në shumë 889.50€ ku i bie 7.43% rritje nga viti i kaluar, pse kjo rritje kur kemi parasysh se nuk është çmim i lartë, dhe në fund një çështje tjetër që ka të bëjë me qiranë për ndërtesa kodi 14110, na intereson të jemi në dijeni se për cilat ndërtesa është fjala.

z.Flakron Gashi, theksoi, më vie mirë që unë mora sqarime nga drejtorët e Drejtorive përkatëse, por ato sqarime ishin vetëm për dy pika, në fakt mora sqarime se nga sa m³ dru përafërsisht iu janë shpërndarë institucioneve arsimore, mirëpo mua më duket jo informatë në çoftë se drejtori nuk është në dijeni se sa ka kushtua dhe sa e ka paguar Komuna një m³ dru në atë kohë, gjegjësisht edhe çështja që drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e përmendi dhe i cili dha sqarime për dy punëtorë që nuk paguhen nga listën e pagave, por aty ka edhe punëtorë tjerë të cilët janë të identifikuar me kontratë për shërbime të veçanta madje ka të atillë që janë nga vitet 2007 dhe nga

2010. Prandaj unë mora sqarim për këto dy pika, mirëpo ishin edhe 8 ose 9 pika tjera për të cilat në një mënyrë vetëm sa u rikonfirmuan ato që unë e thash.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, meqë diskutimet për këtë pikë u shterën dhe nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për diskutim, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 20 vota për, 13 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – qershor 2015.

5. Informatë e Drejtorisë së Arsimit mbi përfundimin e vitit mësimorë 2014/2015

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera shtoi, meqë informatën e keni në formë të shkruar unë nuk do të zgjati shumë, mirëpo vetëm dëshiroj t'ju njoftoj se informata përfshin katër çështje të cilat ndërlidhen drejtpërdrejtë me përfundimin e vitit shkollorë 2014-2015; 1-suksesi i nxënësve në fund të vitit mësimorë në të gjitha nivelet, 2-rezultatet e testit të arritshmërisë për klasat e nënta dhe testit të maturës shtetërore për shkollat e mesme, 3-regjistrimi i nxënësve, parafillorë, të klasave të para dhe atyre në klasë të dhjeta të arsimit të mesëm të lartë, dhe 4-pjesëmarrja e nxënësve të Komunës së Podujevës në organizimin e garave të ndryshme, në nivel shteti, rajoni dhe në nivel ndërkombëtarë, për të cilët mund të them lirshëm se jemi shumë të kënaqur me rezultatet e arritura, mirëpo kemi organizime të ndryshme në nivel komunal të cilat nuk janë të përfshira në këtë informatë.

z.Fidan Rekalu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përshëndesim dhe e falënderojmë drejtorin e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës për këtë informatë e cila është reale dhe e cila paraqet gjendjen faktike në terren. Ne besojmë që vazhdimisht, dita ditës, gjendja në arsimin e Komunës së Podujevës është në përmirësim e sipër, n'kuadër të mundësive që ka Komuna.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kjo është vetëm një informatë rreth gjendjes së arsimit, por në përbërjen e këtij Kuvendi kemi edhe punëtorë të arsimit të cilët më së miri e dinë se si është gjendja e arsimit në Komunën tonë. Mendoj se çka do që flitet sigurisht se mund të merret si tendencioze në aspektin politik, drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili ka qenë drejtor i një shkolle, e përgëzoj për pozitën e re si drejtor i DA dhe i dëshiroj punë të mbarë duke uruar që sistemin e arsimit ta vendosë në rrugën që duhet të jetë. Gjithashtu i uroj nxënësit të cilët kanë qenë shumë të shkëlqyeshëm, dhe ne nuk dyshojmë aspak në aftësitë e fëmijëve dhe qytetarëve tjerë, mirëpo kjo informatë tregon se niveli i arsimit në Komunën e Podujevës ka qenë i njëjtë me nivelin e vitit të kaluar dhe nuk ka pasur zhvillim përpara, me gjithë ato rezultate të arritura nga nxënësit po të ishte punuar më shumë sigurisht se pjesëmarrja do të ishte më e madhe dhe rezultatet do të ishin më të mira. Mund të mos jem i saktë, mirëpo mund të na saktësoi drejtori i Drejtorisë së Arsimit, se në Komunën e Podujevës kanë qenë rreth 21 institucione të arsimit me ushtrues detyre të drejtorit të shkollës, që do të thotë se nuk ka pasur sistem të mirëfilltë në ato shkolla të cilat kanë funksionuar pa ndonjë raportim, dhe ka qenë z.Nexhmi Rudari drejtor i Drejtorisë së Arsimit, tani Nënkrjetarë i Komunës, kur ne kemi thënë përse nuk është hapë konkursi për emërimin e drejtorëve, ndërsa të kaloj një vit pa emërim të drejtorëve të shkollave nuk mendoj se është një gjendje e mirë në arsim, natyrisht sa i përket profilin të mësimdhënësve, profesorëve dhe drejtorëve të shkollave jo sa i përket profilin të

nxënësve sepse këta të fundit marrim mësimdhënie sipas një sistemi që e ndërton Drejtoria e Arsimit, pra kushtet që drejtori i Drejtorisë së Arsimit i krijon në performancën e tij dhe me drejtorët e shkollave në terren atëherë krijohet një ambient dhe mësim më i mirë, ngase shteti i ka ndërtuar linjat e veta duke i ofruar tekstet shkollore, e të tjera mirëpo personeli është çështje komunale e profilit të drejtorëve. Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në mbledhjen e KPF-së na njoftoi se tani është anuluar prapë konkursi për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësrektorëve të shkollave për shkak të mungesës së kualifikimeve adekuatë, çështje për të cilën mendoj se nuk mund të hynë në garë për drejtor të një shkolle asnjë profesor i cili nuk i plotëson kushtet të jetë udhëheqës, dhe se Drejtoria e Arsimit duhet të konsultohet me ligjin e arsimit se kush mund të konkurroj dhe kush jo, e jo të ndodh sikurse që ka ndodhur të thirren në intervista, të intervistohen dhe madje disave t'iu urohet edhe vendi i punës si drejtor i një shkolle e pastaj prapë të kontaktohet dhe t'iu thuhet që kemi vepruar në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ dhe na është dashur të anulohet konkursin. Pra i nderuar drejtor, edhe pse kjo performancë i takon drejtorit të kaluar të Drejtorisë së Arsimit, mua personalisht nuk më pëlqen, nota mesatare, nuk më pëlqen arritshmëria sepse janë të njëjta me vitin paraprak. Dhe konsideroj se nuk mund të ketë arsyetim Drejtoria e Arsimit për mos emërimin e drejtorëve të 21 shkollave të Komunës së Podujevës. Ne i kemi cekur dy-tri shkolla sa i përket mirëmbajtjes dhe gjërave tjera, shkolla “Luigj Gurrakuqi” paralelja e ndarë për të cilën më së miri mund të na tregoj ish drejtori i Drejtorisë së Arsimit se si është gjendja në atë shkollë, ku aty nuk ka kushte për tu zhvilluar mësimi, apo kolegët dhe koleget të cilët janë të fushës së arsimit mund t'iu tregojnë se a ka apo nuk ka kushte për zhvillim të mësimi në atë shkollë, të njëjtën përgjegjësi e kanë edhe inspektorët e arsimit të cilën nuk e kanë paraqitur gjendjen reale për ato shkolla të cilat nuk kanë kushte për mësim, shkolla për të cilat unë drejtorit të kaluar i kam ofruar edhe fotografi të qarta për shkollën “Naim Frashëri” në të cilën është mbyllur një klasë dhe janë bërë bashkë dy klasë, dhe nuk është ndërmarrë asnjë veprim në këtë aspekt, sikurse që për një mandat nuk është marrë asnjë hap rreth paraleles së ndarë në shkollën “Luigj Gurrakuqi”, kurse arsyetohen 290,000.00 € për mirëmbajtje të shkollave. Jemi në dijeni se Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i ndërton objektet e shkollave mirëpo Komuna i mirëmban shkollat dhe krijon kushte për zhvillim të sporteve nga ana e nxënësve, pastaj i riparon ato objekte e të tjera, unë vetëm i mora si shembull këto dy shkolla, por të jeni të sigurt se ka edhe shkolla tjera ku për katër vite nuk është ndërmarrë asnjë hap. Pra do të doja të zbatohej ligji për arsim dhe të shpallet konkursi për drejtor dhe të pranohen dhe të fillon punën më seriozisht drejtori i ri i Drejtorisë së Arsimit.

z.Haki Rudari, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje shpesh herë kemi kërkuar informata në lidhje me arsimin, por megjithatë mendoj se është shumë pozitive, serioze dhe e frytshme kur kemi debat për çështje të ndryshme nga Drejtoritë e ndryshme, dhe kur kemi të bëjmë me debat për ndonjë Drejtor mendoj se në atë Drejtor edhe përkundër vërejtjeve të dhëna punohet dhe ka vlerë kurse në anën tjetër ka shumë Drejtor të cilat në këtë mandat ende nuk kanë paraqitë asnjë informatë.

Sa i përket informatës përkatëse mendoj se është një informatë jo e plotë dhe jo përshtetëse dhe është sipërfaqësore, megjithatë në pjesën e dytë kur thuhet te kalueshmëria e testit të maturës në afatin e qershorit 2015 për shkollat e mesme të larta është 60.15% e që krahasuar me vitin paraprak në të njëjtin afat është 17.49% më e ulët, andaj e kemi një përqindje më të ulët se në vitin e kaluar dhe nuk mund t'i gëzohemi këtij

fakti. Çështje tjetër që e ka përcjell këtë vit kalendarik është se në këtë informatë thuhet për vitin shkollorë për vitin 2014/2015, mirëpo më shumë është informatë nga gjysmëvjetori i dytë, e them këtë ngase unë kam kërkuar një informatë për përfundimin e vitit shkollorë e cila nuk ka ardhur. Ky vit shkollorë është përcjellë me parregullsi të shumta siç janë; infrastruktura ku unë mendoj se shumë pak ka investime në shkolla dhe shumë të pakta janë ato shkolla me të cilat mund të krenohemi, pastaj furnizimi me tekste shkollore ku në shkollën që unë punoj ka përfunduar viti shkollor pa u pajisur nxënësit me libra shkollorë dhe këtë do të ndërlidhë me një shumë të cilën e kam përcjellë në Kuvendin e Kosovës ku thuhet se 500,000.00 € janë harxhuar për botim të librave, të cilat nuk janë shpërndarë gjë të cilën e ka pranuar edhe Ministri i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë por që fajin më të madh e hedh në Drejtoritë e Arsimit të Komunave të Kosovës. Çështje tjetër të cilën e ka përcjellë ky vit shkollorë është edhe pranimi i kuadrit për të cilin nuk mund t'i gëzohemi këtij procesi për arsye se lëre më që ka përfunduar por kemi pasur mësimdhënës i cili ka dhënë disa lëndë dhe që asnjë prej tyre nuk e ka pasur profesion si dhe ka shumë mësimdhënës të cilët punojnë me profesion jo adekuat, andaj kur krejt këto ndërlidhen sigurisht se edhe përqindja e rezultateve bie, e kam thënë dhe po e përsëris se ka kaluar koha kur një mësimdhënës t'i jap tri-katër lëndë kur kemi parasysh faktin se kemi shumë mësimdhënës nga të gjitha lëmit dhe drejtimet duke pritur me përgatitje të lartë superiore. Problem tjetër është edhe pajisja e shkollave me kabinete, me biblioteka të ndryshme, pastaj hapja e konkursit për mësimdhënës dhe ushtrimi i detyrës së drejtorëve të shkollave ku ka ndoshta më shumë se një vit që shumë shkolla funksionojnë me ushtrues detyre të drejtorit gjë për të cilën mendoj se nuk është në rregull dhe është dashur që më parë të kryhet por që si duket na është përcjellë edhe në këtë vit, ndonëse ka qenë konkursi i shpallur dhe tani është mbyllë. Gjithashtu tani është hapur konkursi për mësimdhënës dhe vërejtja ime në formë të pyetjes është, a ka orë të fshehura për të cilat nuk është hapur konkurs, e them këtë ngase kam informata se në vitin e kaluar në disa shkolla ka pasur orë të cilat nuk kanë qenë në konkurs dhe kanë dhënë mësim disa mësimdhënës të pakualifikuar madje kam edhe regjistër të disa shkollave, mirëpo për të kursyer kohën, për këtë çështje do të debatoj më gjerë në një mbledhje tjetër me rastin e debatit për fillimin e vitit të ri shkollorë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, botërisht dihet se arsimi është një prej shtyllave kyçe të funksionimit normal të çdo shoqërie, dhe arritjet qofshin ato të mira apo jo të mira janë reflektim se si do të jetë e ardhmja. Nuk jam njohës i mirë i kësaj lëmie, mirëpo disa shifra që i vërejtja në informatë më krijohen disa dilema për të cilat kam disa pyetje dhe nuk di a mundem t'i drejtohem drejtorit të ri të Drejtorisë së Arsimit apo ish drejtorit, fillimisht dua të pyes rreth notës mesatare ku në cikle ka diferencë, dhe atë, nga klasa I – V është 4.37, nga klasa VI –IX është 3.65 dhe në shkollën e mesme 3.07, andaj pyes pse ndodh kjo, a kemi të bëjmë me kualifikimin dhe cilësinë e mësimdhënësve apo ku qëndron problemi. Çështja tjetër ka të bëjë me testin e arritshmërisë ku 56.85 gjegjësisht 6.73% më i ulët, arsyeja thotë, menaxhimi më rigoroz, dhe tani shtrohet dilema se po të menaxhohet më me rigorozitet ky problem a do të thotë që do të bie ende kjo përqindje. Po ashtu testi i maturës shtetërore ka një rënie shumë të madhe prej 18.49% gjë e cila është për keqardhje, Gjimnazi meriton të inkurajohet dhe të mbështetet sepse ka një rezultat shumë të shkëlqyeshëm, mirëpo dy shkollat tjera të cilat kanë nën 50%, madje njëra ka 25% të kalueshmërisë e që i bie se në çdo katër nxënës një prej tyre e ka kaluar testin kurse tre të tjerë kanë ngelur vërtetë, e që vërtetë është për shqetësim. Po ashtu

një çështje tjetër e cila më intereson shumë dhe të cilën e kam ngritur edhe në nivele tjera dhe të cilën do t'ia sugjeroja Drejtorisë përkatëse për trajtim, kam informacione se shumë mësues dhe mësime të tjerë organizojnë kurse private për nxënësit e tyre madje ka të atillë që për fat të keq edhe i kushtëzojnë nxënësit dhe ai kushtëzim nga ana e atyre mësime të tjerë që iu bëhet nxënësve që të vijojnë kurset dhe të paguajnë 15-20 €, mendoj se nuk duhet të tolerohet, dhe për këtë çështje mendoj se duhet të gjenden forma tjera të mësimit plotësues apo të këtyre institucione të regjistruara dhe të licencuara, por jo këtë gjë ta bëjnë mësime të cilët atë që bëjnë në kurse duhet ta bëjnë në shkollë.

z.Bahri Selimi, theksoi, i bashkëngjitëm parafolësve të cilët e than se kjo informatë e Drejtorisë së Arsimit është sipërfaqësore dhe përmban në vete shumë pak informata edhe pse titullin e ka informatë, sa unë kam arritur të analizoj kjo përmban vetëm të arriturat dhe sukseset e Drejtorisë së Arsimit. Mendoj se informata duhet që më shumë të bazohet në ngecjet dhe mbetjet që Drejtoria. Në këtë informatë nuk kam vërejtur një gjë e cila është shumë e rëndësishme të ceket, a do të ishte mirë që kësaj informate t'i bashkëngjitej një listë e mësime të padiplomuar të cilët japin mësim në shkollat tona, unë mendoj se është dashur të bëhet kjo, dhe nën çdo emër të mësime të ishte një paragraf ku përshkruhet një arsyetim, pse ai jep mësim kur është i padiplomuar, përderisa ka njerëz me kualifikimet master e të cilët nuk janë të punësuar, po ashtu mendoj se kjo informatë është dashur të përmban edhe një listë tjetër të mësime të cilët japin mësim në lëndët jashtë profesionit të tyre dhe po ashtu nën çdo emër të tyre do të duhej të ishte një paragraf i cili do të sqaronte, pse, shembull, një biolog e ligjëron historinë ose anasjelltas. Pra mendoj se përderisa një informatë nuk vije nga Drejtoria e Arsimit me ngecjet dhe me të metat që ka arsimi në Komunën tonë, gjithëherë do të ketë edhe rënie në testin e arritshmërisë dhe do të ketë kuadro shumë pak të shkolluar, gjë e cila na dhemb të gjithëve sepse të gjithë kemi fëmijë në shkollë dhe të gjithë dëshirojmë që fëmijët tanë të dalin kuadro i mirë nga këta mësime.

z.Flakron Gashi, theksoi, uroj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit z.Avni Maloku për pozitën e re dhe shpresoj të ketë punë të mbarë dhe suksese. Dua të ndalem vetëm në dy segmente të kësaj informate, sa i përket testit të arritshmërisë dhe kalimit të testit të maturës në dy shkollat e mesme profesionale, shkollat të cilat nuk do të duhej të ishin në këtë gjendje sepse ne jemi në dijeni se jo të gjithë të rinjtë tanë do të mund të bëhen shkencëtarë, por niveli është shumë i dobët, në shkollën teknike "Fan S. Noli" vetëm 25.21% kanë arritur të kalojnë testin e maturës, kurse në shkollën ekonomike "Isa Boletini" kanë arritur të kalojnë testin vetëm 40.82% e nxënësve, dhe kjo tregon se nga këto dy shkollat, po të marrim një mesatare, rreth 67% e maturantëve të këtyre dy shkollave nuk i kanë aftësitë bazike ose të paktën nuk kanë mundur të dëshmojnë se kanë aftësitë bazike. I nderuari drejtor meqë është çështje e ndjeshme, sinqerisht e them se nuk do të doja që asnjëherë deklaratimet tona t'i merrni personale, ne i gëzohemi faktit nëse në atë shkollë mund jetë ndonjë fëmijë i jonë, i ndonjërit prej jush ose i familjarëve tanë, nxënës shumë i mirë, mirëpo ju lutem të merret shumë seriozisht kjo çështje sepse fëmijët tanë mund të jenë të shkëlqyeshëm, por po iu jepet hapësirë që të krijohet një rreth me cilësi dhe ku do të nxjerrën gjenerata të dobëta të cilat do të na kushtojnë shumë së pari neve si Komunë sepse në të ardhmen ata munden me qenë në pozitë tona. Me qenë se vitin e kaluar unë, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, kam ngritur shqetësime që pikërisht në këto dy shkollat ka pasur shkelje ligjore konkretisht Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, mirëpo meqë ish drejtorit të Drejtorisë

së Arsimit tani Nënkyetar i Komunës, n'çështje të tilla, ngritjet dhe shqetësimet e tilla i duken retorikë opozitare atëherë le të mbetet në përgjegjësinë e tij, mirëpo nuk është retorikë kur kemi të bëjmë me shkelje dhe hulumtime të shkeljeve ligjore. Në vazhdim për disa çështje dua të shtroj pyetje drejtorit, si është e mundur që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të organizoj trajnimin për udhëheqjen në arsim dhe të njëjtit ata që e kanë ndjekur atë trajnim të mos kalojnë, kjo është shqetësuese dhe këtu diçka nuk shkon, pastaj, a do të vazhdojnë që ende studentët t'iu dhënë mësim nxënësve, në të kaluarën ka pasur madje njëri edhe është avancuar dhe tani është drejtor i një shkolle e që në kohën sa ka dhënë mësim ka qenë i padiplomuar, por tani pozita e drejtorit është përgjegjësi politike dhe mua nuk më intereson a është i diplomuar apo jo, mandej, a do të vazhdoj prapë pranimi i kuadrit mësimdhënës pa diploma gjë e cila është vërtetuar dhe që nuk ka qenë retorikë por ka qenë një shkelje, si dhe a do të vazhdoj prapë mësimi mbi baza partiake. Dhe në fund po e përmbylli diskutimin tim me një fjalë të urtë që thuhet, dita e mirë shihet në mëngjes, andaj i nderuari drejtor qysh në ditët e para në pozitën tuaj si drejtor i Drejtorisë së Arsimit jeni duke e shkelur një Udhëzim Administrativ, gjë për të cilën mendoj se nuk është keq mos me dit por më keq është mos me pyet, dhe ju mund të pyesni drejtorin e Drejtorisë së Administratës, Nënkyetarin e Komunës ose edhe Kryetarin e Komunës se cilin Udhëzim Administrativ jeni duke e shkelur ti dhe disa drejtor të Drejtorive tjera këtu, e nëse këta nuk e dinë atëherë ju tregoj unë.

z.Bashkim Statovci, theksoi, sa i përket testit të arritshmërisë dhe testit të kalueshmërisë, unë mendoj se ka rritje të përqindjes së efikasitetit të nxënësve, arsyeja është se monitorimi në këtë vit ka qenë shumë më i madh se viteve të kaluara, ne si staf i shkollës jemi mobilizuar që të mos ketë kopjime ose keqpërdorime të testeve në mënyrë që të mos kaloj asnjë nxënës pa dije ngase viteve të kaluara ka pasë raste që nxënësit e mirë kanë pësuar si shkak i atyre të cilët janë munduar të keqpërdorin testet, pra kjo ka qenë arsyeja që rreth 25% e nxënësve të shkollës “Fan S. Noli” nuk kanë arritur të kalojnë testin e maturës shtetërore, unë punoj në atë shkollë dhe ne si shkollë jemi të shqetësuar me nxënësit të cilët regjistrohen në atë shkollë sepse rreth 5% e tyre nuk dinë shkrim – lexim dhe neve si mësimdhënës na duhet që të merremi edhe me shkrim – lexim në vend që të merremi më shumë me punë profesionale. Mendoj se problemi qëndron te cikli i ulët arsimit me të cilin ne fillimisht duhet të merremi ngase shumica e nxënësve të shkollës së lartcekur mendoj se nuk janë nxënës adekuat për atë drejtim, pra nuk do të thotë se përqindja është e vogël, por mendoj se është përqindje e madhe për arsye se një pjesë e madhe e nxënësve që regjistrohen në atë shkollë janë të dobët dhe është shkolla e parë në Komunën e Podujevës për nga numri i atyre që humbin vitin, dhe për këtë jemi të përkushtuar që asnjë nxënës të mos kaloj pa meritë, dhe pikërisht kjo është duke u marrë si shkak që viteve të fundit është pakësuar numri i atyre që dëshirojnë të regjistrohen në shkollën teknike “Fan S. Noli”, dhe konsideroj se niveli më i lartë i mësimdhënies dhe stafit menaxhues është pikërisht në këtë shkollë ku asnjë orë mësimi nuk humb kot. Sa i përket shkollës së fshatit Batllavë, mendoj se nuk ka nevojë të investohet në atë shkollë sepse hapësira e shkollës është e rrethuar, kurse asaj që u tha për paralelen e ndarë nuk mendoj që është e nevojës të investohet sepse është duke u ndërtuar objekti i ri ku sigurisht përfshihet edhe paralelja e ndarë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, dua të sqaroj atë çka e thash më parë rreth përqindjes së kalueshmërisë sepse Nënkyetari i Komunës më hutoi disi kur e tha se ka rritje prej 18.49% të kalueshmërisë së testit, e kam shënimin që e thash dhe prapë po e lexoi,

kalueshmëria e testit të maturës në afatin e qershorit 2015 për tri shkollat e mesme të larta është 60.15% e që krahasuar me vitin paraprak të të njëjtit afat është 18.49% më e ultë, do të thotë kështu e thash në fillim. Çështja tjetër, pa dashur të polemizoj me parafolësin z.Bashkim Statovcin, mirëpo çështjet që parafolësi i ceku mua më shqetësojnë edhe më shumë ngase i bie që rezultati i kalueshmërisë është rreth 25% për arsye të kontrollit të rreptë që është bërë dhe kjo është një kalueshmëri reale, por a mund të ndodh që në Gjimnaz nuk ka pasur kontroll të mirë, si dhe në çoftë se vërtetë 5% e nxënësve të asaj shkolle nuk dinë shkrim – lexim, mendoj se është mjaft alarmante.

z.Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, theksoi, me që për periudhën që përfshihet në këtë informatë unë kam qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit, andaj në atë cilësi do t'iu adresohem, sepse konsideroj se të arriturat apo edhe dështimet eventuale janë pjesë e përgjegjësisë time si ish drejtor i Drejtorisë së Arsimit. Kemi dy teste, 1-testi i arritshmërisë për klasat e IX-ta, i cili për herë të parë këtë vit është menaxhuar ekskluzivisht me mësimdhënës të shkollave të mesme e jo me mësimdhënës të shkollave fillore për shkak se kemi dashur të nxjerrim një rezultat sa më real duke u bazuar në hipotezën që mësimdhënësit e shkollave të mesme janë më të interesuar ta kenë një rezultat më real për shkak se po ata mësimdhënës do t'i mësojnë ata nxënës, do të thotë kemi bërë një riorganizim në menaxhimin e testit të arritshmërisë që është përgjegjësi e Komunës gjegjësisht e Drejtorisë së Arsimit, dhe si rezultat i kësaj në regjistrimin e nxënësve në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” këtë vit janë paraqitur më pak telashe sepse rezultatet kanë dal më reale, kurse ju jeni në dijeni se për tu regjistruar në klasën e X-të në Gjimnaz janë një sërë kriteresh që nxënësit duhet t'i plotësojnë për tu kualifikuar për regjistrim, do të thotë, janë katër kriterë, nëse nxënësi, nuk i ka poenët në testin e arritshmërisë në nivel të caktuar, suksesin e përgjithshëm në nivel të caktuar, poenët e lëndëve adekuate ku aplikon dhe suksesin e lëndëve adekuate ku aplikon, ai nuk mund të hynë në konkurrencë, pra kemi dashur të jemi më rigoroz në mënyrë që ta kemi më të lehtë të bëjmë diferencën në mes atyre të cilët dëshirojnë të regjistrohen në Gjimnaz dhe atyre që fatkeqësisht nuk kanë pasur rezultat të mirë për tu regjistruar në Gjimnaz.

Sa i përket testit të maturës shtetërore, këtë nuk e menaxhon Komuna por e menaxhon komisioni shtetërorë i maturës dhe Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, ne si Drejtori e Arsimit e kemi kryer vetëm punën teknike, mirëpo këtë vit Ministri z.Arsim Bajrami e ka ndërruar testin e maturës dhe për këtë e përgëzoj ngase kësaj radhe testi i maturës nuk është mbajtur në hapësira me 150 nxënës në shkollë por është mbajtur me nga 15 nxënës në një klasë me ç'rast mundësia e keqpërdorimeve, kopjimeve dhe gjërave të ngjashme ka qenë shumë e vogël andaj detyrimisht kjo reflekton edhe në rezultat, mirëpo ka reflektuar shumë pozitivisht në Gjimnaz sepse nxënësit e Gjimnazit kanë qenë më të përgatitur kurse ka reflektuar më negativisht në shkollat profesionale. Suksesi i nxënësve të shkollave profesionale nuk është vetëm problem në Komunën e Podujevës por është problem në nivel vendi, ka shkollë profesionale në Kosovë që testin e maturës në afatin e parë e kanë kaluar vetëm katër nxënës dhe për këtë ka një sërë arsyesh pse në shkollat e mesme profesionale rezultat e testeve janë jo të mira, unë personalisht kam bërë vërejtje edhe në Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, që testet e maturës në lëndët e përgjithshme duhet të jenë të ndryshme për nxënës të shkollave profesionale prej atyre të Gjimnazeve, sepse këtë mund të merrni parasysh kur i njëjti test, shembull, i gjuhës shqipe apo i matematikës dhe lëndëve tjera të përgjithshme është i njëjtë për nxënësit e Gjimnazit dhe për nxënësit e profileve tjera ta zëmë atyre të

zdrukthëtarisë ose atyre që janë automekanik ku detyrimisht nxënësit e këtyre profileve do të kenë një rezultat shumë më të ulët në lëndët e përgjithshme për shkak se kërkesat janë të njëjta, vërejtja ime Ministria e ka marrë seriozisht përsipër që të bëjë diferencë në hartimin e testeve të përgjithshme për këta nxënës sepse nuk mund të krahasohen dhe të kërkesat nga një mekanik ose zdrukthëtar të njëjtat kërkesa sikurse një nxënës i cili përgatitet për studime. Çështja e dytë, sa i përket shkollave profesionale, mendoj se nxënësit kanë mungesë të praktikës profesionale në kompani ose ndërmarrje të ndryshme, dua të them nuk kemi kompani apo ndërmarrje të shumta që nxënësit tanë të shkollave profesionale të mund të kryenin praktikën profesionale ose të bëjnë improvizime në kabinete ose eventualisht nxënësit e drejtimit të Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës bëjnë praktikë në Postë, mirëpo për shumicën e profileve tjera mungojnë kompani ose ndërmarrje të cilat do t'iu ofronin praktikë dhe ngritje profesionale atyre nxënësve. Megjithatë në këtë vit ne kemi ndërtuar një sistem të ashtuquajtur follow up, me të cilin përcjellët regjistrimi në Universitete të nxënësve pas mbarimit të shkollës së mesme të lartë dhe testit të maturës, dhe mund të them se është krenari që në këtë vit shumica e nxënësve të Gjimnazit janë regjistruar në Universitetin Publik të Kosovës dhe një kënaqësi e veçantë ngase këtë vit, siç jeni në dijeni, kriteret për regjistrim në Universitetin Publik të Kosovës kanë qenë shumë të fuqishme por që nxënësit tanë në të gjitha profilet kanë treguar rezultat shumë të mirë, pra këto informata ne i kemi zyrtare dhe është një numër i madh i atyre që janë regjistruar që nga Fakulteti i Mjekësisë deri te Fakulteti i Edukimit.

z.Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, u tha nga një parafolës se gjoja unë i kam thirr disa persona të cilët kanë konkurruar për pozitën drejtor të shkollës dhe iu kam uruar pozitën e re si drejtor të ndonjë shkolle, kjo nuk qëndron dhe këtë çështje e kam sqaruar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e vërteta është se pas dy-tri dite që jam emëruar në këtë pozitë, kemi qenë të detyruar të bëjmë njoftim publik me arsyet e ripërsëritjes së konkursit për drejtorë dhe zëvendës drejtor të shkollave, ngase kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet e parapara sipas Udhëzimit Administrativ përkatës. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e kemi parë të arsyeshme që më mirë është që konkursi të ripërsëritet se sa të bëhen shkelje eventuale. Meqë Nënkryetari i Komunës e sqaroi çështjen e testeve të arritshmërisë dhe të maturës, unë nuk do të ndalem në detaje por vetëm dua të them se kur kemi të bëjmë me suksesin ose rezultatet e nxënësve në këto teste nuk mund të themi ose të bëjmë kritika ngase ngritjet dhe uljet e përqindjeve të rezultateve të testeve ndikohen prej shumë faktorëve dhe rezultatet nuk varen dhe nuk bëhen brenda një muaji ose një viti shkollorë, nëse bëhen analiza në bazë të këtyre fakteve që janë në këtë informatë për periudhën përkatëse, për shkollat është diçka normale sepse informata ka të bëjë me përfundimin e vitit mësimorë me një dinamikë normale, pra kjo është vetëm një informatë, nuk është raport sepse po të ishte raport ne sigurisht se do të hynim në tema tjera. Andaj këto janë të dhëna reale të cilat janë mbledhur dhe nuk mund të ndërrohen por nëse hymë në analizë duhet të kemi një mori faktesh çoftë të brendshme çoftë të jashtme, në mënyrë që të mund të diskutojmë, të bëjmë analiza, të konkludojmë për të ardhmen e arsimit në Komunën e Podujevës e gjëra të tjera. U tha nga një parafolës se unë gjoja jam duke e shkelur një Udhëzim Administrativ, unë nuk jam në dijeni se për çfarë pretendohet, por nëse është fjala rreth konkursit për drejtorë të shkollave konsideroj se nuk kam bërë shkelje. Sa i përket çështjeve që u ceken lidhur me

pranimin e mësimdhënësve, siç u tha pa diploma, pa kualifikime e të tjera, unë ju rikujtoj se ende jemi në procesin e konkursit për pranimin e mësimdhënësve, të gjitha vendet e shpallura faktikisht janë vende të lira, mirëpo pa dashur të fajësoj Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, në momentet e fundit janë publikuar dy Udhëzime Administrative nga kjo Ministri, njëri rregullon çështjet që kanë të bëjnë me kuadrin e përgjithshëm ndërsa tjetri rregullon çështjet e kuadrit profesional, dhe tani pasi që kemi bërë të gjitha konsultimet brenda për brenda kemi caktuar një takim me përfaqësuesit e MASHT-it ku kemi munduar të gjejmë një interpretim të saktë dhe të përshtatshëm mes Udhëzimit të mëparshëm dhe dy Udhëzimeve të reja ngase gjendja faktike në terren qëndron krejt ndryshe nga ajo çfarë kërkohet me Udhëzimet e reja, mirëpo ende nuk na është kthyer ndonjë sqarim, andaj kemi qenë të detyruar që prapë të konsultohemi brenda për brenda dhe të gjejmë një formë e cila është më e mira por pa i cenuar Udhëzimet Administrative, shembull, në të kaluarën kemi pasur mësimdhënës me kualifikim Bachelor por ju ka shpallur konkursi, mirëpo tani me këto Udhëzime të reja është një dispozitë sipas së cilës i jepet një mundësi atij punëtori që deri në një përdhë të caktuar të vazhdoi të punoj por që brenda një afati të caktuar të pajiset me kualifikim përkatës, pra jemi para disa situatave të ndryshme për të cila jemi munduar të jemi të kujdesshëm dhe shpresojmë që edhe kjo çështje do të rregullohet.

z.Flakron Gashi, theksoi, sqarim, i nderuari drejtor nuk është fjala për shkeljen e Udhëzimeve Administrative të MASHT-it, por e lëmë këtë për një seancë tjetër të radhës e sqarojmë se për cilin Udhëzim Administrativ bëhet fjalë të cilin jeni duke e shkelur ju dhe disa drejtorë të disa Drejtorive tjera këtu, nëse nuk iu tregon drejtori i Drejtorisë së Administratës se cilin Udhëzim Administrativ jeni duke e shkelur atëherë do të tregoi unë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, dhe atë, gjatë mandatit tuaj, a do të ketë profesorë të padiplomuar të cilët do të ligjërojnë në shkollat e mesme të Komunës së Podujevës, të cilët do të zbresin koeficientin 18%. Pastaj, si do të veproni me profesorët e padiplomuar të cilët janë në marrëdhënie pune deri në muajin shtator 2015. Përgjigjet është mirë t'i japin ekskluzivisht ata ndaj të cilëve parashtrohet pyetja. Sa i përket asaj që ish drejtori i Drejtorisë së Arsimit tani Nënkyetar i Komunës e tha se në këtë vit ka pasur monitorim më të shtuar të testit të arritshmërisë dhe atij të maturës, unë mendoj se monitorimi duhet të jetë 100% ngase nxënësi i aftë ku do që të jetë është në gjendje të mbush testin.

z.Haki Rudari, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, për pjesëmarrje në gara shtetërore në lëndën e matematikës nxënësi Besart Kodraliu është mbështetur me subvencione nga Komuna, përse nuk është specifikuar ky subvencionim. Pastaj, përse nuk figuron fare në informatë dhënia e bursave për studentë, mendoj se është dashur të jetë pjesë e kësaj informate për arsye se ka pasur shumë ankesa nga studentët dhe ka pasur ndarje ku disa studentëve absolutisht iu është thënë se juve nuk ju takon bursa kurse ka pas raste që iu janë dhënë bursat të njëjtëve. Sa i përket asaj që drejtori i Drejtorisë së Arsimit e tha se kjo periudhë për të cilën është bërë kjo informatë nuk i takon periudhës time, unë mendoj se kjo është në kontinuitet për arsye se kjo parti udhëheqë me Komunën që nga paslufta dhe asnjëherë nuk mund të thuhet një gjë e tillë. Po ashtu dua të ngris një shqetësim që ka të bëjë me organizimin e ekskursionit në Shqipëri, ne kemi pasë vërejtje vitin e kaluar dhe po e shtrojmë si çështje edhe në këtë vit, nxënësit në Shqipëri janë duke shkuar me një çmim shumë të lartë rreth 115-120 € kurse ne mësimdhënësit për aq ditë qëndrimi sikurse nxënësit, paguajmë rreth 60-65 €,

andaj konsideroj se drejtori i Drejtorisë së Arsimit duhet të ketë edhe këtë për bazë duke pasur parasysh gjendjen e rëndë materiale të qytetarëve.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fillimisht e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për këtë informatë, gjithashtu falënderoj të gjithë këshilltarët dhe anëtarët e Ekzekutivit të Komunës për këtë debat.

6. Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distributum dhe Furnizim Me Energji Elektrike – KEDS

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar në lidhje me këtë propozim vendim, dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, andaj në çoftë se nuk ka të lajmëruar për diskutim, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 32 vota për, 2 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua ky propozim vendim.

7. Propozim vendimet për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Fadil Latifit nga fshati Llapashticë e Poshtme dhe Mustaf Abazit nga fshati Sallabaj)

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan:

-propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Fadil Latifit nga fshati Llapashticë e Poshtme, dhe

-propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Mustaf Abazit nga fshati Sallabaj.

8. Propozim vendimet për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (për ndërtimin e objektit të Qendrës për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve në fshatin Sfeqel)

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim.

9. Të Ndryshme

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, kam një kërkesë, sigurisht se të gjithë ne jemi dëshmitarë për kushtet e punës që i kemi në këtë sallë, gjithherë duke shpresuar që do të përfundoj objekti i ri i Komunës kemi mbetur në këtë gjendje dhe në këtë sallë e cila para 40 viteve i ka pasë kushtet më të mira se sa që i ka tani, meqë si duket objekti i ri do të vazhdoj në pafundësi të mbetet ashtu siç është, unë kërkoj që kjo sallë e Kuvendit të rregullohet në mënyrë që të krijohen kushte optimale për punë sepse këto ulëse ngjajnë si në sistemi paralel të kohërave të shkuara kur organizonim tubime të ndryshme nëpër podrume.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, një ndër vizitat e Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje është edhe vizita në Çerdhe, ku ndër të tjera kemi hasur në shumë mangësi siç janë; mungesa e higjienës, mungesa e parkingut për stafin punues dhe punëtorët, mungesa e gjelbërimit dhe kopshtit, mungesa e këndit të lojërave në ambient të hapur për fëmijët, e mbi të gjitha mungesa e kontrolleve mjekësore për disa vite e që është mangësi dhe absurde për fëmijët që të kalojnë një pjesë të kohës bukur të gjatë në ambient të papastër dhe pa kontrolle mjekësore. Andaj kërkojmë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që të ndërmerr diçka lidhur kontrollet mjekësore pasi që kjo nuk është e kushtueshme sepse mjekët mund të shkojnë edhe në mënyrë vullnetare. Çështje tjetër që dua të ngris është edhe ndërtimi i rrethrotullimit në magjistralen Podujevë – Prishtinë në hyrje të Podujevës afër hotel Besiana ngase është shqetësuese për qytetarët pasi që pothuajse çdo javë ndodhin aksidente dhe vërtetë krijohet një kaos i vërtetë në atë rrugë, kështu që dua të ngris si çështje në mënyrë që të ndërmerret diçka lidhur me zgjidhjen e këtij problemi, pra të ndërtohet një rrethrotullim në magjistrale konkretisht afër hotel Besianës.

z. Haki Rudari, theksoi, kam dy pyetje, e para ka të bëjë me degradimin e ambientit në xeheroren në Drazhnje, pyetje të cilën e kam bërë edhe më parë mirëpo nuk kam marrë përgjigje, në atë vend është duke vazhduar degradimi i ambientit, andaj kërkoj përgjigje, dhe pyetja e dytë është për Drejtorinë e Inspeksionit, a keni inspektuar pishinat për të parë se a janë të pajisura me raport nga instituti i shëndetësisë publike për analizat bakteriologjike, kimike dhe fizike të ujit, e shtrova këtë duke pasë për bazë kohën e cila është vapë e madhe dhe shumë nxënës vizitojnë pishinat ku mund të marrin sëmundje apo infektim të lëkurës, gjithashtu në bazë të ligjit për shëndetësinë publike pishinat duhet të kenë të punësuar zhytës, pra është mirë të informohemi se si është vepruar në këtë drejtim.

Pasi nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi mbledhjen të mbyllur duke nënvizuar, muajin gusht e kemi pushim por në qoftë se paraqitet nevoja për ndonjë mbledhje urgjente sigurisht se do ta mbajmë me ata këshilltarë që vijnë, andaj ju dëshiroj pushime të këndshme.

Mbledhja përfundoi në orën 12;55

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-70402
Podujevë,
31 korrik 2015**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**